

U D H Ë Z I M
Nr. 7, datë 16.6.2003

“PËR AKCIZAT”

Në zbatim të nenit 55 të ligjit nr. 8976 “Për akcizat”, Ministri i Financave nxjerr këtë

U D H Ë Z I M

PJESA I – DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Zbatimi

1.1 Ky udhëzim zbatohet për mallrat që tatohen me akcizë në Republikën e Shqipërisë dhe ndaj çdo personi që prodhon dhe/ose tregton mallra akcize, si dhe për troje, ndërtesa ose ambiente të tjera ku mbahen ose prodhohen mallra akcize, sipas përcaktimeve në nenin 2 të ligjit nr. 8976 “Për akcizat” (që në vijim do t’i referohemi shkurt “Ligji”).

1.2 Ky udhëzim hyn në fuqi më 1 korrik 2003. Megjithatë, në rrethanat kur një personi, objekt i këtij udhëzimi, i kërkohet të bëjë ndryshime materiale në magazinën e miratuar tatimore dhe në rast se personi në fjalë do të prodhojë ose tregtojë mallra akcizë përpara 1 korrikut, çdo ndryshim i tillë duhet të kryhet deri më 1 shtator 2003.

Formularët dhe shënimet e paraqitura në shtojcat bashkëngjitur këtij udhëzimi janë pjesë e udhëzimit dhe kanë fuqi të njëjtë ligjore.

1.4 Prodhimi i mallrave të akcizës përfshin:

- a) prodhimin e mallrave të akcizës nga lëndë të para që nuk janë subjekt akcize;
- b) përpunimin dhe/ose ambalazhimin e mallrave të akcizës që rezulton në një rritje apo ulje të vëllimit apo peshës së mallrave të akcizës, pavarësisht nëse akciza mbi mallrat e akcizës ka qenë paguar ose jo përpara përpunimit ose ambalazhimit.

PJESA II – AUTORIZIMI DHE MIRATIMI

2. Autorizimi për tatimpaguesit e akcizës

Kërkesa për marrjen e autorizimit për trajtimin e mallrave të akcizës (nga një “tatimpagues i autorizuar i akcizës”), sipas nenit 4 dhe nenit 7 të ligjit duhet të paraqitet dorazi nga personi që kërkon autorizimin (“aplikanti”), të paktën 30 ditë përpara datës së parashikuar për fillimin e veprimtarisë tregtare ose, nëse personi është aktualisht tatimpagues akcize, jo më vonë se data 1 korrik 2003, duke përdorur formularin në shtojcën 1. Formulari duhet të dorëzohet në degën e tatimeve të rrethit ku është vendndodhja kryesore e biznesit të aplikantit.

Çdo aplikant duhet të jetë i rregullt dhe i besueshëm, gjë që nënkupton se nuk duhet të ketë detyrime të pashlyera që rezultojnë në tatime të papaguara ndaj administratës tatimore, shuma të papaguara ndaj ndonjë organi tjetër shtetëror, kontribute sigurimesh shoqërore ose taksa lokale të papaguara, duhet të mos ketë vuajtur ndonjë lloj dënimi penal pesë vitet e fundit, duhet të ketë një adresë tregtare në Republikën e Shqipërisë, duhet të sigurojë garancitë e kërkuara sipas pjesës III të këtij udhëzimi dhe të jetë i aftë të zbatojë kërkesat e ligjit në lidhje me akcizën.

Administrata tatimore mund të refuzojë dhënien e autorizimit nëse aplikanti konsiderohet person jo i rregullt sipas paragrafit 2.2 më lart.

Çdo autorizim akcizë i lëshuar sipas dispozitave të këtij udhëzimi do të jetë i vlefshëm për një periudhë 12-mujore.

Në rastet kur aplikanti nuk ka zbatuar kërkesat e ligjit dhe të këtij udhëzimi, organi tatimor mund të refuzojë rinovimin e autorizimit të lëshuar.

Vendimi lidhur me kërkesën për autorizim të tatimpaguesit të akcizës jepet nga organi tatimor brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës, përveçse në rastet kur të dhënat e kërkesës ose të aplikantit janë nën investigim.

Emërtimi “nën investigim” në paragrafin 2.6 më lart, përfshin rrethanat kur informacioni i kërkuar nga organi tatimor për të vendosur nëse aplikanti është apo jo person i rregullt dhe i besueshëm, nuk është konfirmuar.

Autorizimi i parashikuar nga ky udhëzim dhe dispozitat e nenit 4 të ligjit, mund të lëshohet edhe pa marrë miratimin për një magazinë tatimore. Megjithatë, mungesa e miratimit për magazinë tatimore, nënkupton që personit të autorizuar nuk i lejohet të mbajë mallra akcize të çfarëdolloji nën regjimin e pezullimit tatimor.

Një person, i cili nuk është një përfaqësues tatimor dhe bën kërkesë për marrjen e autorizimit sipas këtij udhëzimi, pa bërë kërkesë për miratimin e magazinës tatimore, duhet të paraqesë informacionin e mëposhtëm, duke deklaruar sipas rastit, që informacioni është i përkohshëm dhe duke konfirmuar që informacioni përfundimtar do të jepet i saktë në momentin e kërkesës për miratim të magazinës tatimore:

procesin e prodhimit që do të kryhet;

normativat e lëndëve të para që përdoren për prodhimin e mallrave të gatshme të akcizës;

humbjet në prodhim ose ruajtje gjatë ecurisë së zakonshme të biznesit.

Në autorizimin e akcizës që i jepet përfaqësuesit tatimor, i cili do të furnizojë me pulla prodhuesin jashtë vendit, do të përcaktohet se si do të bëhet ngjitja e pullave në njësinë e ambalazhimit.

Çdo kërkesë duhet t'i bashkëngjitet një mandatpagesë që vërteton pagesën e shumës së parimbursueshme prej 10 000 lekësh.

3. Kërkesa për miratimin e magazinës tatimore

Një tatimpagues akcize i autorizuar që dëshiron të prodhojë mallra akcize (përveç atyre personave që klasifikohen brenda përkufizimit të nenit 4 (7) të ligjit) ose të mbajë mallra nën regjimin e pezullimit tatimor (përveçse kur mbahen në një magazinë të miratuar si magazinë doganore nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave) duhet ta bëjë këtë vetëm në një magazinë të miratuar tatimore.

Kërkesa për miratimin e një magazine tatimore duhet të paraqitet duke përdorur formularin në shtojcën 2 të këtij udhëzimi dhe, bashkë me të gjithë informacionin plotësues që kërkon formulari, duhet të dorëzohen në degën e tatimeve që mbulon magazinën tatimore të propozuar, të paktën 30 ditë përpara se aplikanti të fillojë veprimtarinë tregtare (ose përpara 1 korrikut 2003, nëse është tatimpagues ekzistues akcize).

Çdo kërkesë duhet t'i bashkëngjitet një mandatpagesë që vërteton pagesën e shumës së parimbursueshme prej 10.000 lekësh.

Aplikanti nuk duhet:

- të blejë ose të marrë me qira tokë posaçërisht për ndërtimin e një magazine tatimore,
- të blejë një ndërtesë me qëllimin e vetëm të përdorimit të saj si magazinë tatimore;
- të fillojë ndonjë punë ndërtimore apo strukturore,
- të ndërmarrë veprime të tjera,
- duke marrë të mirëqenë miratimin e magazinës tatimore.

Çdo miratim për magazinë tatimore, i lëshuar sipas dispozitave të këtij udhëzimi, do të jetë i vlefshëm për një periudhë 12 muajore.

Si pjesë e procesit të shqyrtimit për miratimin e një magazine tatimore, punonjësi i degës tatimore përgjegjës për kërkesën e magazinës tatimore, do të vizitojë ambientin dhe do të kryejë një inspektim të përgjithshëm. Punonjësi do të ketë me vete formularin e kërkesës dhe hollësitë e planit të propozuar për magazinën tatimore. Ai duhet të verifikojë nëse informacioni i paraqitur në kërkesë është i saktë. Punonjësi duhet të verifikojë që:

- Ekziston garancia financiare për sigurimin e akcizës mbi mallrat e akcizës të magazinuara në magazinën tatimore.

- Plani i paraqitur pasqyron me saktësi planimetrinë e magazinës tatimore të propozuar.

- Lëndët e para ruhen në një ambient të veçantë brenda magazinës, që është i ruajtur dhe mund të kyçet, dhe asnjë lëndë e parë nuk mund të hyjë apo dalë nga ambientet e magazinimit pa u regjistruar dhe evidentuar siç duhet.

- Ambientet për magazinimin e mallrave të mbajtura në regjimin e pezullimit tatimor janë të përcaktuara qartë dhe të ndara nga ambientet ku mbahen mallrat e tatueshme, dhe asnjë mall, qoftë i pezulluar ose i tatueshëm, nuk mund të hyjë ose të dalë nga magazina pa u regjistruar dhe evidentuar ashtu siç duhet.

- Aplikanti duhet të kuptojë dhe të zbatojë të gjitha kërkesat për mbajtjen e regjistrimeve. Në rastet kur regjistrimet mbahen në kompjuter, sistemi i informatizuar duhet të jetë në gjendje të

riprodhojë të dhënat e kërkuara dhe të nxjerrë raporte periodike sipas këtyre udhëzimeve.

- Depozitat që do të përdoren në magazinën tatimore të propozuar duhet të kenë të shënuar qartë një numër identifikimi dhe vëllimin e tyre;

- Testimi i të gjitha pajisjeve matëse është bërë në mënyrën e duhur;

Të kontrollohet mënyra e ngjitjes së pullave të akcizës për të siguruar zbatimin e këtij udhëzimi dhe veçanërisht duhet të miratohen materialet që do të përdoren për ngjitjen e pullave të akcizës.

- Të gjitha hapësirat ku magazinohen mallrat e akcizës, të ambalazhuara ose jo, të jenë të sigurta dhe të mbahen të kyçura.

Në rrethanat kur informacioni i dhënë nuk është i saktë, kërkesa ose plani duhet ndryshuar duke shpjeguar shkaqet e këtij gabimi.

3.7 Miratimi për magazinë tatimore nuk do të jepet nëse aplikanti nuk paraqet një garanci për magazinë tatimore të miratuar nga një institucion financiar i miratuar, në përputhje me dispozitat e parashikuara në pikën 10 më poshtë.

Për miratimin e një magazinë tatimore duhet të përmbushen kushtet e mëposhtme:

- Mallrat e ambalazhuara të akcizës duhet të magazinohen në hapësira që mundësojnë lehtësisht dallimin dhe numërimin e tyre.

- Çdo mall akcizë duhet të jetë lehtësisht i identifikueshëm me anë të caktimit të një numri reference të stokut (mallit gjendje) dhe datës së prodhimit.

- Mallrat e akcizës për eksport duhet të dallohen lehtë dhe të jenë të gatshme për inspektim.

- Të mbahen regjistra të veçantë në zbatim të dispozitave të ligjit dhe të këtij udhëzimi.

- Magazina tatimore duhet të ruhet dhe të ketë një sistem sigurimi në mënyrë që të minimizohet rreziku i vjedhjes së mallrave të akcizës. Sistemi i sigurimit duhet të sigurojë që të gjitha hyrjet të mbyllen dhe të kyçen mirë, dhe atje ku ka dritare të vihen hekura. Çdo person që mban çelës dhe që hap dhe mbyll dritare dhe dyer, duhet të jetë i autorizuar nga dega e tatimeve që mbulon magazinën tatimore dhe emrat e çelësmbajtësve të autorizuar duhet të renditen në dokumentin e miratimit të magazinës tatimore.

- të gjitha pajisjet që përdoren për prodhimin, matjen ose magazinimin e lëndëve të para, produkteve të ndërmjetme apo produkteve të gatshme të akcizës, duhet të kontrollohen, numërohen ose plumbosen.

Organet tatimore mund të refuzojnë rinovimin e autorizimit të akcizës, lëshuar sipas nenit 5 të ligjit dhe këtij udhëzimi, në rrethanat kur aplikanti nuk ka zbatuar kërkesat e ligjit dhe të udhëzimit ose mund të refuzojë dhënien e miratimit për magazinën tatimore, kur magazina tatimore nuk përmbush ndonjë nga kushtet e përcaktuara në paragrafin 3.8 më sipër ose kur aplikanti ka kërkuar miratimin për një operacion që nuk lejohet nga dispozitat e ligjit ose udhëzimit.

Vendimi për miratimin e kërkesës për autorizimin e magazinës tatimore do të jepet nga administrata tatimore brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës, përveçse në rastet kur të dhënat e aplikimit apo aplikantit janë duke u investiguar.

3.11 Përkufizimi “nën investigim” në paragrafin 3.10 më lart, përfshin ato raste kur organi tatimor nuk është i kënaqur me ndonjë aspekt të kërkesës për magazinë tatimore, përfshirë edhe masat e sigurisë dhe metodat që do të përdoren në magazinën tatimore të propozuar për të matur sasinë e mallrave të prodhuara të akcizës në magazinën e propozuar tatimore.

3.12 Autorizimi i lëshuar sipas këtij udhëzimi do të mbahet gjatë gjithë kohës në magazinën tatimore për të cilën lëshohet dhe duhet t’i paraqitet punonjësit tatimor sipas kërkesës në raste inspektimi.

3.13 Organet tatimore mund t’ia transferojnë miratimin e magazinës tatimore një personi tjetër, nëse ky person është një tatimpagues i autorizuar akcize sipas nenit 4 të ligjit, me një kërkesë të shkruar dhe pas vërtetimit të pagesës së një tarife administrative prej 5,000 lekësh.

4. Revokimi (heqja) e autorizimit si tatimpagues akcize ose e miratimit për magazinë tatimore

Revokimi (heqja) e autorizimit të tatimpaguesit të akcizës, në kuptimin e nenit 9(3) të ligjit, mund të bëhet në rastet kur:

- tatimpaguesi i autorizuar i akcizës, për çdo magazinë tatimore të administruar prej tij, nuk ka paguar në kohë akcizën mbi 4 herë brenda një periudhe 12-mujore në të cilën është paralajmëruar me

shkrim nga organet tatimore;

- tatimpaguesit i është bërë rivlerësim për një tatim të papaguar të akcizës më tepër se 3 herë brenda një periudhe 12-mujore ose ka marrë një paralajmërim me shkrim për heqje të autorizimit gjatë asaj periudhë 12-mujore;

- tatimpaguesi ka reklamuar në mënyrë të qëllimshme një vlerë akcize që nuk i takon;

- tatimpaguesi ka penguar një punonjës tatimor për ushtrimin e detyrës;

- tatimpaguesi ka kryer veprime që e klasifikojnë atë si person të parregullt dhe të pabesueshëm.

Arsye për revokimin e autorizimit të tatimpaguesit të akcizës, shprehur në nenin 9(3) të ligjit, do të konsiderohen ato raste kur tatimpaguesi i autorizuar i akcizës nuk ka siguruar nivelin e kërkuar të garancisë financiare; nuk ka mbajtur ose azhurnuar të dhënat e duhura, edhe pasi është paralajmëruar me shkrim nga punonjësi i tatimeve; ka vazhduar të kryejë operacione të paautorizuara ose ka përdorur pajisje të paautorizuara apo kur i është revokuar garancia financiare nga garantuesi i autorizuar dhe nuk e ka zëvendësuar atë.

Organi tatimor duhet të njoftojë tatimpaguesin e autorizuar të akcizës dhe/ose operatorin (administratorin) e një magazine të miratuar tatimore për qëllimin e revokimit të autorizimit/miratimit të lëshuar sipas nenit 4 dhe/ose 5 të ligjit, duke e informuar atë për datën në të cilën autorizimi/miratimi do të shfuqizohet. Data e shfuqizimit duhet caktuar jo më herët se 90 ditë nga data e njoftimit të revokimit, me përjashtim të rastit kur revokimi bëhet për arsye të tërheqjes së garancisë së kërkuar nga garantuesi, rast në të cilin, data e revokimit për miratimin e magazinës tatimore (dhe jo autorizimit) do të jetë data kur skadon garancia.

Nëse pas datës së skadimit të miratimit për magazinë tatimore, ka ende ndonjë sasi mallrash për të cilat nuk është paguar akcizë:

a) akciza për këto mallra duhet të paguhet menjëherë;

b) organi tatimor mund të bëjë kërkesë kundrejt një garancie financiare ekzistuese për ato mallra;

c) mbështetur në dispozitat e nenit 41 të ligjit, organi tatimor mund t'i sekuestrojë këto mallra.

PJESA III – GARANCITË FINANCIARE

5. Detyrimi për garancinë

Në rrethanat kur organi tatimor kërkon një garanci për magazinën tatimore si kusht për lëshimin e miratimit të magazinës tatimore sipas nenit 5(3) të ligjit, duhet të zbatohen dispozitat e këtij udhëzimi.

Kryetari i degës së tatimeve mund të miratojë kërkesën e një tatimpaguesi të autorizuar akcize, lidhur me një garanci të pjesshme për magazinën tatimore për:

a) magazinat e reja tatimore të miratuara pas 1 korrikut 2003, kur këto magazina tatimore janë miratuar si të tilla në më shumë se dy vite pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi;

b) magazinat tatimore, në të cilat prodhoheshin mallra akcizë që përpara hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, gjatë shqyrtimit të kërkesës për garanci të pjesshme për magazinën tatimore do të merret parasysh periudha e kohës gjatë të cilës magazina tatimore ka operuar në mënyrë të rregullt;

c) tatimpaguesit e autorizuar të akcizës që kanë plotësuar kushtet e miratimit përkatës për magazinën tatimore;

d) tatimpaguesit e autorizuar të akcizës që kanë paguar shumën e duhur të akcizës në kohën e duhur gjatë gjithë periudhës që mbulon miratimi;

e) rastet kur shuma e tatimit të akcizës së papaguar mbi mallrat e akcizës të magazinuara në një magazinë tatimore, në çdo kohë, nuk i kalon 2 000 000 lekët.

Nivelet e garancisë së pjesshme për magazine tatimore shpjegohen në pikën 10 me poshtë.

6. “Garantuesi i miratuar”

Vetëm institucionet financiare të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve mund të veprojnë si garantues. Çdo institucion financiar që kërkon miratim si garantues i miratuar, duhet të bëjë një kërkesë pranë organit tatimor duke përdorur formularin e paraqitur në shtojcën 3, të dorëzojë dokumentet që kërkohen në shënimet e formularit dhe të paraqesë një listë të nënshkruesve të autorizuar zyrtarisht me shkrim nga institucioni financiar, e cila do të mbetet në fuqi derisa të

amendohet zyrtarisht me shkrim nga institucioni financiar.

Për qëllim të këtij udhëzimi, “garantuesi i miratuar” është një institucion financiar i autorizuar që merr përsipër t’i paguajë administratës tatimore një shumë të barabartë me akcizën për t’u paguar apo një shumë tjetër për t’u arkëtuar si akcizë e pagueshme, por e papaguar mbi mallrat e akcizës që mbulohen nga kushtet e garancisë, siç përcaktohet më poshtë në paragrafin 8.1 të këtij udhëzimi, në rastin kur një tatimpagues i autorizuar akcize nuk arrin të paguajë tatimin e duhur apo çdo shumë tjetër për t’u arkëtuar si tatim për t’u paguar mbi mallrat e akcizës të mbuluara nga kushtet e garancisë.

7. Tatimpaguesi i autorizuar i akcizës është përgjegjës për përgatitjen e garancisë

Tatimpaguesi i autorizuar i akcizës përgjegjës për pagimin e akcizës është përgjegjës për përgatitjen e një garancie të miratuar me garantuesin e miratuar.

Detyrimi i tatimpaguesit të autorizuar të akcizës nuk kufizohet në shumën që mbulon garancia. Organi tatimor mund të bëjë vlerësim tatimor për tatimpaguesin e autorizuar të akcizës për të gjithë tatimin e pashlyer të akcizës që rezulton nga parregullsitë në magazinën tatimore ose gjatë çdo lëvizjeje për të cilat tatimpaguesi i autorizuar i akcizës ka siguruar një garanci.

8. Garancitë

Termi “garanci e miratuar” ka të njëjtin kuptim si ajo që është dhënë në nenin 2 të ligjit dhe është një marrëveshje ndërmjet garantuesit të miratuar, tatimpaguesit të autorizuar të akcizës dhe organit tatimor, ku garantuesi i miratuar është institucioni financiar që duhet të veprojë në përputhje me dispozitat e paragrafit 6.1 më lart.

Garancia duhet mbajtur në magazinën tatimore përkatëse dhe duhet t’i paraqitet punonjësit tatimor sa herë që kërkohet.

Në rrethanat kur mbahet një garanci për vendndodhje të ndryshme, një kopje e garancisë duhet të mbahet në secilën nga magazinat tatimore përkatëse.

9. Kërkesa për garancinë

Për marrjen e garancisë së miratuar për magazinën tatimore, duhet të bëhet një kërkesë pranë degës së tatimeve duke përdorur formularin në shtojcën 4.

Kërkesat do të pranohen për:

- a) një garanci për magazinë tatimore;
- b) një garanci për lëvizjen e mallrave të akcizës;
- c) një garanci të përbashkët për magazinën tatimore dhe lëvizjen;
- d) një garanci për magazina tatimore në vendndodhje të ndryshme, me kusht që operatori (administratori) i magazinës tatimore të jetë i njëjti person për të gjitha magazinat tatimore.

Garantuesi duhet të dorëzojë formularin e kërkesës pranë degës tatimore që mbikëqyr magazinën tatimore, të cilës i referohet garancia ose degës tatimore që mbulon vendin kryesor të biznesit në rastin e garancive për vendndodhje të ndryshme.

Dega e tatimeve nuk do të lëshojë një miratim për magazinë tatimore, po të mos ketë një garanci të vlefshme për magazinën tatimore dhe të miratuar nga dega e tatimeve.

Leja për lëvizjen e mallrave në regjimin e pezullimit tatimor nuk do të jepet po të mos ketë një garanci të vlefshme për lëvizjen dhe të miratuar nga dega tatimore.

Në rastet kur kërkohet një garanci për magazinë tatimore dhe një garanci lëvizjeje, mund të pranohet një garanci e vetme, e përbashkët, me kusht që shuma e garancisë të jetë e mjaftueshme për të përmbushur detyrimet sipas pikës 10 më poshtë dhe detyrimet të jenë të ndara qartë ndërmjet detyrimit të akcizës në magazinën tatimore dhe detyrimit mbi lëvizjet në regjimin e pezullimit tatimor.

9.7 Në rrethanat kur kërkohet një garanci për vendndodhje të ndryshme, ku me garanci për vendndodhje të ndryshme nënkuptojmë një garanci që mbulon detyrimet e më shumë se një magazine tatimore që administrohet dhe zotërohet nga i njëjti person, mund të pranohet një kërkesë e vetme, me kusht që në formularin e kërkesës të përfshihen të dhënat që lidhen me të gjitha detyrimet e akcizës për çdo magazinë tatimore të subjektit që bën kërkesën.

9.8 Nëse kërkesa për garanci pranohet, dega e tatimeve përgjegjëse për magazinën dhe vendin kryesor të biznesit të tatimpaguesit të autorizuar të akcizës, sipas rastit do t’i dërgojë një letër pranimi garantuesit dhe tatimpaguesit të autorizuar të akcizës duke ruajtur kërkesën në dosjet e degës tatimore.

10. Nivelet e garancisë

10.1 Niveli i garancisë që kërkohet për magazinën tatimore do të llogaritet në lidhje me vlerën potenciale të akcizës mbi gjendjen e stokut në fund të muajit, si më poshtë:

- a) më pak se 2 000 000 lekë – nuk kërkohet asnjë garanci;
 - b) më e vogël ose e barabartë me 100 milion lek – 100% e detyrimit tatimor;
 - c) më e madhe se 100 milionë lekë, por jo mbi 250 milionë lekë - 100% e detyrimit deri në 100 milionë lekë plus 25% e detyrimit të mbetur;
- mbi 250 milionë lekë - 100% e detyrimit deri në 100 milionë lekë plus 25% të detyrimit deri në 250 milionë lekë plus 10% e detyrimit të mbetur.

10.2 Në rrethanat kur një tatimpagues i autorizuar i akcizës bën kërkesë për një garanci të pjesshme për magazinën tatimore sipas pikës 5.2 të udhëzimit më lart, niveli i garancisë së pjesshme do të llogaritet si më poshtë:

- a) për 2 vite përmbushjeje të rregullt të detyrimeve tatimore - 75% të niveleve të specifikuara në paragrafin 10.1 më lart;
- b) për 5 vite përmbushjeje të rregullt të detyrimeve tatimore - 50% të niveleve të specifikuara më lart në paragrafin 10.1;
- c) për 7 vite përmbushjeje të rregullt të detyrimeve tatimore - 25% të niveleve të specifikuara më lart në paragrafin 10.1.

10.3 Niveli i kërkuar i garancisë së lëvizjes do të llogaritet duke iu referuar shumës mesatare të akcizës së pezulluar në lëvizjet e një jave, e llogaritur kjo duke iu referuar të gjitha lëvizjeve në 12 muajt e mëparshëm nga tatimpaguesi i autorizuar i akcizës.

10.4 Në rrethanat kur subjektet e akcizës nuk kanë zhvilluar biznes për një periudhë 12-mujore, garancia do të llogaritet mbi nivelin e akcizës së parashikuar paraprakisht të lëvizjeve të pezulluara gjatë lëvizjeve mesatare të një jave.

10.5 Përveç dispozitave në 10.3 më lart, administrata tatimore mund t'i kërkojë një subjekti akcize që të sigurojë një garanci, që do të mbulojë shumën maksimale të akcizës së pezulluar për një lëvizje të vetme. Kjo dispozitë do të zbatohet kur:

- a) operatori i magazinës tatimore nuk ka lëvizur më parë mallra nën regjimin e pezullimit tatimor;
- b) operatori i magazinës tatimore ka vonuar pagesën e tatimit të akcizës më shumë se një herë gjatë dy viteve të fundit;
- c) operatori i magazinës tatimore ka marrë më shumë se dy vlerësime sipas nenit 14 të ligjit gjatë 12 muajve.

10.6 Organi tatimor do të monitorojë nivelin e garancisë në lidhje me lëvizjet nën regjimin e pezullimit tatimor dhe mallin gjendje të çdo personi që ka një garanci dhe do të kërkojë një rritje në nivelin e garancisë financiare të kërkuar, në rastet kur detyrimi i akcizës rritet me një vlerë të konsiderueshme. Monitorimi nënkupton krahasimin e të dhënave që mbahen nga tatimpaguesi i akcizës në lidhje me stokun e mbajtur dhe të lëvizur nga magazina tatimore, sipas garancive ekzistuese.

10.7 Në rrethanat kur niveli i mallit gjendje dhe/ose lëvizjet e mallrave të akcizës të një tatimpaguesi të autorizuar të akcizës nën regjimin e pezullimit tatimor kanë rënë ose janë rritur, ai person mund të bëjë një kërkesë pranë degës së tatimeve në rreth për zvogëlimin ose rritjen e nivelit të garancisë duke dorëzuar një kërkesë të re sipas formularit në shtojcën 4.

10.8 Shuma e akcizës së garantuar me çfarëdolloj garancie në fuqi nuk prek kompetencat e organit tatimor sipas nenit 14 të ligjit për të vlerësuar një shumë akcize që e tejkalon shumën e garantuar.

11. Tërheqja e një garancie

Garancia do të mbetet në fuqi, derisa të njoftohet si e tërhequr nga garantuesi ose derisa garancia të skadojë sipas datës së caktuar nga garantuesi në formularin e garancisë. Megjithatë, organi tatimor duhet të njoftohet 30 ditë përpara për tërheqjen e garancisë nga garantuesi dhe garancia do të mbetet në fuqi, derisa të përfundojë ky afat, përveçse në rastet kur garancia është zëvendësuar nga një garanci e re nga i njëjti garantues.

Kur një garanci tërhiqet ose skadon dhe tatimpaguesi i autorizuar i akcizës nuk e zëvendëson garancinë, organi tatimor do të revokojë miratimin përkatës të magazinës tatimore dhe akciza mbi

mallrat e akcizës në magazinë duhet të paguhet menjëherë dhe asnjë mall akcize nuk mund të nxirret nga magazina nën regjimin e pezullimit tatimor, përveçse në rastet kur lëvizja e mallrave mund të përfundohet përpara tërheqjes apo skadimit të garancisë ose kur mbulohet nga një garanci individuale lëvizjeje.

Garancia nuk mund të tërhiqet sa kohë që vazhdon lëvizja e kategorive të ndryshme të mallrave të akcizës nën regjimin e pezullimit tatimor, derisa detyrimi tatimor mbi ato mallra të sigurohet nga një garanci tjetër ose të paguhet plotësisht, ose të garantohet sipas kërkesave të organit tatimor.

12. Kërkesat kundrejt garancive

Detyrimet tatimore të papaguara do t'i njoftohen garantuesit kryesor me anë të lëshimit të një vlerësimi sipas nenit 14 të ligjit që ka të bëjë me tatimpaguesin e autorizuar të akcizës në magazinën tatimore të miratuar ku lindi detyrimi tatimor, ose nga e cila ngarkesa është larguar nën regjimin e pezullimit tatimor duke mos u evidentuar.

Organi tatimor do të bëjë kërkesë kundrejt një garancie vetëm nëse personi i autorizuar nuk ka paguar një vlerësim të lëshuar sipas nenit 14 të ligjit dhe, pasi është bërë kërkesa kundrejt garancisë, administrata tatimore do t'i kërkojë garantuesit që të bëjë pagesën.

Organi tatimor do të bëjë një kërkesë kundrejt garancisë, duke i lëshuar një letërkërkesë garantuesit për shumën e vlerësuar të akcizës së papaguar nga tatimpaguesi i autorizuar i akcizës, sipas pikës 12.1, duke kërkuar pagesën e akcizës së papaguar deri në nivelin që mbulohet nga garancia në fuqi. Kërkesa nuk i nënshtrohet procesit të apelimit dhe shuma e kërkuar duhet të paguhet brenda pesë ditëve-pune. Çdo shumë e vlerësuar sipas pikës 12.1, por e papaguar nga garantuesi do të mbetet borxh i pashlyer nga tatimpaguesi i autorizuar i akcizës.

PJESA IV – LËVIZJA E MALLRAVE TË AKCIZËS

13. Lëvizja e mallrave të akcizës nga magazina tatimore nën regjimin e pezullimit tatimor

13.1 Dispozitat e kësaj pike duhen koordinuar me dispozitat e pikave 55 deri 58 më poshtë.

13.2 Përpara se ngarkesat e mallrave të akcizës të lënë magazinën tatimore, tatimpaguesi i autorizuar i akcizës duhet të njoftojë dy ditë më përpara degën e tatimeve sipas formularit në shtojcën 5.

Të gjitha lëvizjet e mallrave të akcizës nën regjimin e pezullimit tatimor ndërmjet magazinave tatimore të miratuara në Republikën e Shqipërisë ose nga një magazinë e miratuar për eksport, duhet të shoqërohen nga dokumenti i lëvizjes në shtojcën 6. Të gjitha rubrikat përkatëse të formularit duhet të plotësohen dhe të verifikohen nga dega tatimore përpara se mallrat të lëvizin.

Lëvizjet e mallrave të akcizës nën regjimin e pezullimit tatimor mund të kryhen vetëm pasi dega e tatimeve të ketë kontrolluar mallrat që do të lëvizin, me përjashtim të rasteve kur dega e tatimeve të ketë autorizuar me shkrim tatimpaguesin e autorizuar të akcizës, përgjegjës për pagesën e akcizës mbi mallrat e akcizës në ngarkesë, për të lëvizuar mallrat pa i kontrolluar ato. Lëshimi i një lejeje të tillë bëhet vetëm në rrethanat kur nuk është e mundur që punonjësi të jetë i pranishëm në datën e parashikuar të nisjes, me kusht që, tatimpaguesi i autorizuar i akcizës t'i përmbahet detyrimit të njoftimit sipas paragrafit 13.2 më lart dhe në të njëjtën kohë shuma e akcizës për ngarkesën të jetë më pak se 100 000 lekë.

Automjeti ose konteineri me të cilin do të transportohen mallrat e akcizës, duhet të jetë i tipit të miratuar, si dhe duhet të plotësohen kushtet e plumbosjes sipas udhëzimit 16.

Tatimpaguesi i autorizuar i akcizës plotëson në magazinën tatimore dokumentin e lëvizjes në tri kopje dhe ia dorëzon punonjësit të degës së tatimeve. Punonjësi do të verifikojë ngarkesën kundrejt regjistrave të magazinës dhe dokumentit të lëvizjes, e nëse mbetet i kënaqur, do të nënshkruajë të tri kopjet, duke mbajtur kopjen e tretë e duke i kthyer kopjen e parë dhe kopjen e dytë tatimpaguesit të akcizës. Nëpërmjet nënshkrimit, punonjësi vërteton sasinë e mallrave të akcizës dhe numrin e përdorur të vulave.

Tatimpaguesi i akcizës duhet të dërgojë kopjet 1 dhe 2 të dokumentit të lëvizjes së bashku me ngarkesën e mallrave të akcizës në magazinën pritëse ose vendin e eksportit sipas rastit dhe t'ia paraqesë dokumentin punonjësit të degës së tatimeve në magazinën tatimore pritëse ose në doganë, sipas rastit.

Dega e tatimeve që mbulon magazinën ose doganën pritëse duhet t'i firmosë të dyja kopjet e dokumentit të lëvizjes duke deklaruar që vulat janë të paprekura ose të pahapura. Nëse ngarkesa kontrollohet, sasisë dhe lloji i mallrave të akcizës, të verifikuara duhet të shënohen në dokumentin e lëvizjes. Kopja e parë mbahet nga dega e tatimeve për magazinën ose doganën pritëse sipas rastit. Kopja e dytë duhet t'i kthehet magazinës së nisjes.

Doganat duhet të kontrollojnë nëse vula e të gjitha ngarkesave të mbërritura për eksport është prekur, fallsifikuar apo ka humbur.

14. Marrja në dorëzim e mallrave nën regjimin e pezullimit tatimor në magazinën tatimore

Një magazinë tatimore mund të pranojë vetëm kategoritë e mëposhtme të mallrave të akcizës nën regjim pezullimi tatimor:

a) mallra akcize që janë prodhuar ose ambalazhuar në Republikën e Shqipërisë dhe dërgohen ose livrohen për në magazinat tatimore që janë pronë dhe administrohen nga i njëjti person;

b) ngarkesat tregtare të mallrave që janë prodhuar ose ambalazhuar në Republikën e Shqipërisë dhe dërgohen ose livrohen dhe për në magazinat tatimore që janë pronë dhe administrohen nga i njëjti person;

c) ngarkesat tregtare të mallrave të akcizës që janë importuar, me kusht që të zbatohen dispozitat sipas udhëzimit 15.

Për rastet e lëvizjes së parashikuar në paragrafët 14.1(a) dhe (b) më lart, duhet të zbatohet procedura e përcaktuar në paragrafët 14.3 deri 14.7, ndërsa për rastet e lëvizjeve në paragrafin 14.1 (c) duhet të zbatohet procedura e përcaktuar në pikën 15.

Të paktën 2 ditë përpara marrjes së mallrave të akcizës, tatimpaguesi i akcizës përgjegjës për magazinën tatimore pritëse, i paraqet inspektorit të degës së tatimeve që gjendet në magazinën tatimore të dy kopjet e dokumentit të lëvizjes.

Në ditën e mbërritjes së mallit, tatimpaguesi i autorizuar i akcizës në magazinën tatimore pritëse, duhet të informojë degën e tatimeve përgjegjëse për kontrollin e magazinës tatimore pritëse, për kohën e parashikuar të mbërritjes së ngarkesës. Njoftimi mund të bëhet gojarisht.

Në mbërritjen e ngarkesës nën pezullim tatimor, tatimpaguesi i autorizuar i akcizës për magazinën pritëse, duhet të paraqesë në degën e tatimeve të dyja kopjet e dokumentit të lëvizjes. Dokumentet duhet të përpunohen nga dega e tatimeve sipas paragrafëve 13.6 dhe 13.8 më lart.

Asnjë ngarkesë e mallrave të akcizës nën regjimin e pezullimit tatimor nuk mund të shkarkohet pa praninë e punonjësit të degës së tatimeve, i cili duhet të verifikojë mbërritjen e mallrave në magazinën tatimore, me përjashtim të rasteve kur dega e tatimeve i ka dhënë leje me shkrim tatimpaguesit të autorizuar për shkarkimin e mallit pa praninë e punonjësit të degës së tatimeve.

Një leje e tillë mund të lëshohet në rastet kur punonjësi i degës së tatimeve nuk mund të jetë i pranishëm në datën e mbërritjes së mallit dhe kur tatimpaguesi i autorizuar i akcizës të ketë përmbushur detyrimin e njoftimit për lëvizjen dhe në të njëjtën kohë shuma e akcizës të jetë më e vogël se 100 000 lekë.

15. Marrja në dorëzim e ngarkesave të importuara të mallrave të akcizës nën regjimin e pezullimit tatimor

Kur një ngarkesë e mallrave të akcizës duhet të importohet dhe të vendoset në një magazinë tatimore të autorizuar, duhet të ndiqet procedura e mëposhtme.

Të paktën 2 ditë përpara datës së parashikuar për mbërritjen e mallrave të akcizës në magazinën e miratuar tatimore, tatimpaguesi i autorizuar i akcizës duhet të njoftojë degën e tatimeve për mbërritjen e mallit me anë të formularit në shtojcën 5.

Me marrjen e njoftimit për mbërritjen e mallrave, organi tatimor e pajis tatimpaguesin me formularin e shtojcës 6 (dokumenti i akcizës që shoqëron mallin). Ky formular plotësohet nga tatimpaguesi në tri kopje në bazë të dokumentacionit të importit që shoqëron mallin dhe dorëzohet pranë autoriteteve doganore së bashku me deklaratën doganore të importit (DAV) dhe me të gjitha dokumentet e tjera të importit që shoqërojnë mallin.

Formulari i lëvizjes së mallit (shtojca 6), i dorëzuar në organin doganor, duhet të përmbajë numrin e tij të identifikimit, si dhe nënshkrimin dhe vulën e organit tatimor.

Organi doganor me marrjen e të gjithë praktikës doganore të parashikuar në pikën 15.3 më lart, procedon me kontrollin dokumentar të deklaratës doganore dhe të shtojcës 6, duke verifikuar

përputhshmërinë ose jo të deklarimit të bërë nga tatimpaguesi me dokumentet, shoqëruese të mallit.

Pas kryerjes së procedurës së zhdoganimit, organi doganor pasqyron në shtojcën 6 rezultatet e kontrollit dhe vendos në të njëkohësisht edhe referencat e DAV të importit në kutinë 2. Kopja e tretë e dokumentit të lëvizjes (shtojca 6), i bashkëngjitet praktikës doganore, ndërsa dy kopjet e tjera shoqërojnë mallin.

Tatimpaguesi paguan detyrimin doganor, TVSH-në, taksën e rrugës dhe sipas rastit edhe taksat e tjera, por nuk paguan akcizë.

Në kutinë 47 të deklaratës doganore, në një rresht të veçantë do të përllogaritet vlera e akcizës dhe përkrah saj do të vendoset shënimi “pezullim tatimor”, ndërsa në kutinë 44 të deklaratës doganore do të vendoset numri i identifikimit të tatimpaguesit dhe data e dokumentit të lëvizjes (shtojca 6).

Dogana firmos dokumentin e lëvizjes me zbulimet e kontrollit së bashku me të dhënat e vulave të përdorura dhe mban kopjen e tretë të dokumentit të lëvizjes:

a) Kur dokumenti mbërrin në pikën doganore të importit dhe vula e ngarkesës është e paprekur, punonjësi doganor nënshkruan formularin e lëvizjes së mallrave ku edhe deklaron se në momentin e mbërritjes së ngarkesës në doganë, vula ishte e paprekur dhe se nuk ishin kryer kontrolle doganore mbi ngarkesën.

b) Nëse vërehet se vula është thyer ose falsifikuar, ose kur dogana kërkon të ushtrojë një kontroll fizik të ngarkesës, punonjësi doganor duhet të kontrollojë sasinë e mallrave të akcizës brenda ngarkesës dhe të firmosë formularin e lëvizjes duke shënuar sasinë e mallrave të akcizës brenda në ngarkesë.

c) Në rastet kur, për qëllimet e kryerjes së një kontrolli sipas Kodit Doganor, vula thyhet nga doganat, ose kur vula e dërguesit është thyer apo prekur, punonjësi i administratës doganore duhet të riplumbosë ngarkesën me një vulë doganore ose të mbikëqyrë vendosjen e një vule nga shoqëria speditonere dhe të nënshkruajë formularin e lëvizjes duke shënuar sasinë e gjetur të mallrave të akcizës dhe numrin e ri të vulës.

15.10 Pasi mallrat të jenë zhdoganuar në doganën e hyrjes, tatimpaguesi i akcizës ose një agjent që vepron në emër të tij, njofton verbalisht degën tatimore përkatëse për kohën e parashikuar të mbërritjes së ngarkesës së mallrave të akcizës në magazinën tatimore të destinacionit dhe deklaron nëse ngarkesa ka vulën e dërguesit ose, nëse është kryer një kontroll doganor mbi mallrat dhe, prej këtu mallrat duhet të dërgohen drejtpërdrejt në magazinën tatimore duke ndjekur rrugën më të shkurtër të shoqëruar nga kopja e parë dhe e dytë e dokumentit të lëvizjes.

15.11 Nëse në momentin e mbërritjes së ngarkesës punonjësi i degës së tatimeve nuk është i pranishëm në magazinën tatimore pritëse, duhet njoftuar menjëherë dega e tatimeve për mbërritjen e mallit.

15.12 Punonjësi i degës së tatimeve duhet të kontrollojë sasinë e mbërritur të mallrave të akcizës kundrejt sasisë së mallrave të akcizës në dokumentin që shoqëron lëvizjen nga vendi i importit dhe të firmosë në dy kopje gjetjet e rezultuara nga ekzaminimi. Kopja e parë duhet të mbahet nga punonjësi dhe të vendoset në dosjen e tatimpaguesit dhe kopja e dytë i kthehet doganës në pikën e importit.

15.13 Në rastet kur sasia e mbërritur e mallrave të akcizës është më e vogël, sesa sasia në dokumentin e lëvizjes, duhet të zbatohen dispozitat e pikës 24 të këtij udhëzimi.

15.14 Asnjë ngarkesë e mallrave të akcizës nën regjimin e pezullimit tatimor nuk mund të shkarkohet pa praninë e punonjësit të degës së tatimeve, i cili duhet të verifikojë mbërritjen e mallrave në magazinën tatimore, përveçse në rastet kur dega e tatimeve i ka dhënë leje me shkrim tatimpaguesit të autorizuar të akcizës për shkarkimin e mallit pa praninë e punonjësit të degës së tatimeve.

15.15 Dega e tatimeve mund të lëshojë një leje të tillë vetëm në rastet kur nuk ka asnjë punonjës të pranishëm në datën e mbërritjes së mallit dhe kur tatimpaguesi i autorizuar i akcizës ka zbatuar procedurën e kryerjes së njoftimit dhe shuma e akcizës për t’u paguar nuk i tejkalon 100 000 lekë, por leja nuk jepet nëse organet doganore nuk kanë ushtruar kontroll mbi ngarkesën.

15.16 Kur shkarkimi është autorizuar të kryhet pa praninë e punonjësit tatimor, tatimpaguesi i autorizuar i akcizës duhet të marrë masa për ruajtjen e vulës doganore ose tregtare pas heqjes dhe numri i vulës të jetë shënuar në dokumentin e lëvizjes. Sasia e mallrave të akcizës duhet të regjistrohet në regjistrat e magazinës dhe në formularin e lëvizjes dhe, nëse rezulton ndonjë mospërputhje ndërmjet sasisë në formularin e lëvizjes dhe në sasinë faktike të mbërritur, duhet të njoftohet menjëherë, ose në rastin me të parë të volitshëm, dega e tatimeve.

15.17 Importet e mallrave të akcizës nga përfaqësitë diplomatike të akredituara në Shqipëri ose organizatat ndërkombëtare, që kanë një marrëveshje të ratifikuar në Kuvend për përjashtim nga akciza, duhet të kryhen dhe të kontrollohen sipas procedurave të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

PJESA V - MIRATIMI I KONTEINERËVE (DEPOZITAVE), AUTOMJETEVE DHE VULAVE QË PËRDOREN PËR LËVIZJEN E MALLRAVE TË AKCIZËS

16.1 Lëvizjet e mallrave të akcizës nën regjimin e pezullimit tatimor mund të kryhen vetëm në konteinerë dhe automjete, dyert dhe pjesët e të cilave që çojnë tek mallrat e akcizës të jenë të plumbosura në mënyrë të tillë që, kur dera ose pjesë të tjera të konteinerit dhe automjetit të hapen, prishja (thyerja) e vulës të jetë e pashmangshme dhe numri i vulës të jetë shënuar në dokumentin e lëvizjes (sipas shtojcës 6).

Për qëllimet e këtij udhëzimi me “konteiner” nënkuptojmë çdo lloj depozite (tanker, rifuxho) që përdoret për të transportuar ngarkesat tregtare të mallrave të akcizës, me përbërje metalike dhe kur të gjitha hyrjet e konteinerit të mallrave e akcizës duhet të plumbosen.

Për qëllimet e këtij udhëzimi një “automjet” nënkupton çdo mjet të motorizuar transporti që mund të plumboset. Një automjet nuk mund të përdoret për transportimin e mallrave të akcizës, kur anët e automjetit përbëhen nga pëlhurë ose material tjetër i butë, ose kur mallrat nuk janë të mbuluara.

Për qëllimet e këtij udhëzimi, me “vulë” nënkuptohet një pajisje treguese që duhet të shkatërrohet kur hapet konteineri ose automjeti në të cilin është instaluar, në mënyrë që mos të përdoret përsëri.

Në rastet kur gjatë verifikimit nga punonjësi tatimor vihet re që vula nuk është konform specifikimit të kërkuar atëherë:

a. duhet paguar akciza për ngarkesën;

b. lëvizja e ngarkesës nuk duhet të lejohet, derisa të vihen vulat e duhura.

Çdo përdorues i vulave duhet të zbatojë kushtet e mëposhtme:

a) vulat duhet të kenë një shenjë të përhershme unike identifikimi, të kenë numër serial dhe të përdoren sipas radhës;

b) të gjitha vulat dhe pajisjet për vulosje duhen të mbahen të kyçura dhe çelësi duhet të mbahet nga personi përgjegjës i tatimpaguesit të akcizës;

c) duhet mbajtur një regjistër i përhershëm i stoqeve që të tregojë marrjen e mallit, numrat serialë, përdorimin dhe shkatërrimin e vulave, i cili duhet t'i paraqitet punonjësit përkatës të degës së tatimeve me kërkesën e këtij të fundit;

d) e gjithë gjendja e vulave duhet të inspektohet rregullisht dhe të rakordohet;

e) të gjitha vulat me defekt dhe vulat e hequra pas përdorimit duhet të inspektohen nga një punonjës i organit tatimor përpara shkatërrimit të tyre, që bëhet në mënyrën e miratuar;

f) shenjat e numrave të vulave duhet të tregohen qartë në dokumentet që shoqërojnë mallrat e akcizës dhe të verifikohen përpara lëvizjes së tyre sipas pikës 13.4 më lart;

g) vulat mund të vihen ose të hiqen nga personeli i magazinës tatimore që është autorizuar nga administrata tatimore. Personi i autorizuar është ai që përmendet në miratimin e magazinës tatimore, që ka kompetencën e duhur për përdorimin e vulave.

PJESA VI - REGJISTRIMET

17. Regjistrimet e magazinës tatimore

Çdo person i autorizuar sipas nenit 4 të ligjit, në çdo magazinë të miratuar tatimore, sipas biznesit të akcizës që kryen, duhet të mbajë regjistrimet e mëposhtme në mënyrën e përshkruar në paragrafët 17.2 dhe 17.4 më poshtë:

a) regjistri i të gjitha lëndëve të para të marra, siç specifikohet në miratimin për magazinën tatimore, sipas formularit të përcaktuar në shtojcën 7;

b) regjistri i prodhimit duke përdorur një faqe të veçantë për çdo cikël prodhimi, në formën dhe mënyrën e përcaktuar në shtojcën 8; çdo cikël prodhimi i caktohet një numër brenda një serie vijuese vjetore;

- c) regjistri i materialit ambalazhues gjendje dhe shpërndarjes së tij, në formën dhe mënyrën e përcaktuar në shtojcën 9;
- d) regjistri i daljes nga magazina tatimore të mallrave të tatueshme, sipas shtojcës 10;
- e) regjistri i daljes nga magazina tatimore të mallrave në regjim pezullimi, sipas shtojcën 11;
- f) regjistri i mbetjeve, në formën dhe mënyrën e përcaktuar në shtojcën 12;
- g) llogaritë vjetore;
- gj) dokumentet bankare;
- h) regjistrat e arkës dhe regjistra të tjerë kontabiliteti;
- i) dokumentet e importit dhe eksportit;
- j) librat e shitjeve dhe blerjeve;
- k) faturat e blerjes dhe shitjeve;
- l) korrespondenca e të gjitha bizneseve.

Operatorët e magazinave tatimore të miratuara vetëm për magazinim dhe shpërndarje, nuk janë të detyruar të mbajnë regjistra në lidhje me prodhimin e mallrave të akcizës.

Në rastet kur lloji i biznesit të akcizës nuk kërkon mbajtjen e të gjithë regjistrave të renditur në paragrafin 17.1 më lart, tatimpaguesi i autorizuar i akcizës, në marrëveshje me shkrim me degën e tatimeve mund të përdorë regjistra të ndryshëm, të cilët i paraqet së bashku me kërkesën me shkrim. Kërkesa për të mbajtur regjistra të ndryshëm duhet të provojë që me anë të tyre realizohet skema e kontrollit dhe paraqitja e plotë e informacionit.

Kur regjistrat mbahen në mënyrë të informatizuar ata duhet të paraqesin të njëjtat të dhëna, ashtu si dhe regjistrat e përcaktuar në paragrafin 17.1 më lart.

18. Regjistrimet e përfaqësuesit tatimor

Personi i autorizuar si përfaqësues tatimor sipas nenit 7 të ligjit, duhet të mbajë të gjitha të dhënat në lidhje me ngarkesat e mallrave të akcizës për të cilat është i detyruar të paguajë tatimin e akcizës, përfshirë këtu:

- a) llogaritë vjetore;
- b) dokumentet bankare;
- c) regjistrat e arkës dhe të dhëna të tjera kontabiliteti;
- d) dokumente importi dhe eksporti;
- dh) librat e blerjes dhe shitjes;
- e) faturat e blerjes dhe shitjes;
- f) të gjithë korrespondencën e biznesit.

Përveç kësaj, përfaqësuesi tatimor duhet të mbajë të dhëna për çdo tatimpagues që përfaqëson, ku të një përmbledhjeje e të gjithë shumës së akcizës së pagueshme për çdo periudhë tatimore (muaj kalendarik).

Përfaqësuesi tatimor nuk mund të mbajë asnjë mall akcizë në kuadrin e regjimit të pezullimit tatimor.

19. Deklarata e mallit gjendje (stokut)

Përveç regjistrimeve të renditura në pikën 17 më lart, për çdo muaj kalendarik, duhet të përgatitet një deklaratë e stokut që përmban informacionin e duhur, e cila duhet të jetë në formën dhe mënyrën e përcaktuar në shtojcën 14 dhe duhet të dorëzohet në degën e tatimeve që mbulon magazinën tatimore me të cilën ka lidhje deklarata e stokut, në ditën e 15 të muajit që vijon pas atij, të cilit i referohet deklarata.

PJESA VII – KONTROLLET NDAJ MAGAZINIMIT TË MALLRAVE NË NJË MAGAZINË TATIMORE

20. Magazinimi dhe regjistrimi i lëndëve të para

Lëndët e para duhet të mbahen në një vendndodhje të veçantë për magazinim brenda magazinës tatimore, në planimetrinë e dorëzuar si pjesë e miratimit të magazinës tatimore, në mënyrë që të mund të identifikohen lehtë.

20.2 Çdo mbërritje lëndësh të para në magazinën tatimore dhe shpërndarjet e lëndëve të para

nga ambienti i ruajtjes së lëndëve të para brenda magazinës, duhet të maten dhe të regjistrohen në regjistra, siç është përcaktuar në pikën 17 dhe në shtojcën 7.

21. Magazinimi dhe regjistrimi i mallrave të akcizës që janë nën pezullim tatimor

Mallrat e akcizës që i janë nënshtruar regjimit të pezullimit tatimor mund të mbahen vetëm në një magazinë tatimore të miratuar, në hapësira të veçanta, të përcaktuara qartë brenda planimetrisë së paraqitur si pjesë e miratimit të magazinës tatimore.

Për mallrat e ambalazhuara të akcizës, çdo kuti ose paletë duhet të ketë përmasa standarde sipas përmasave të veçanta të paketës, shishes ose konteinerit.

Kur vera dhe pijet alkoolike, përpara se të ambalazhohen për t'u shitur me pakicë, vendosen në një konteiner me vëllim më të madh se 5 litra, në konteiner duhet shënuar numri i serisë së prodhimit të mallrave të akcizës dhe data e magazinimit, përveç shenjave dhe numrave që identifikojnë konteinerin sipas kushteve të përcaktuara në miratimin e magazinës tatimore.

Mallrat e akcizës që normalisht kërkojnë pulla akcize, por janë për eksport duhet të mbahen në një ambient veçmas nga ambienti ku mbahen mallrat e akcizës që kanë pulla akcize, në përputhje me planin e dorëzuar si pjesë e miratimit të magazinës tatimore.

22. Magazinimi në magazinën tatimore i mallrave për të cilat paguhet akcizë

22.1 Mallrat për të cilat paguhet akcizë (përfshi mallrat e akcizës me pullë) mund të mbahen vetëm në një magazinë tatimore të miratuar, në hapësira të përcaktuara veçanërisht për to, veçmas nga mallrat që janë nën regjimin e pezullimit tatimor dhe që janë përcaktuar qartë brenda planit të paraqitur në formularin e kërkesës. Tatimpaguesi duhet të ketë në dispozicion dokumentet që vërtetojnë pagesën e akcizës të cilat përfshijnë:

- regjistrat që tregojnë se, kur është paguar tatimi dhe kur është bërë shpërndarja e mallrave për të cilat është paguar akciza (kur mallrat janë prodhuar nga një operator i autorizuar i magazinës tatimore në të cilën mbahen);

- dokumentin e livrimit, faturën tatimore dhe/apo dokumentin bankar në lidhje me pagesën e akcizës, në rrethanat kur mallrat, për të cilat akciza është paguar, nuk janë prodhuar nga operatori i magazinës tatimore.

PJESA VIII - HUMBJET

23. Detyrimi i pagesës së akcizës

Akciza e pagueshme mbi mallrat e akcizës nuk duhet të paguhet kur ka humbje, siç përcaktohet në nenin 13 të ligjit, nëse kjo humbje llogaritet dhe shpjegohet sipas dispozitave të këtij udhëzimi.

24. Humbjet e mallrave të akcizës në transit

24.1 Për ngarkesat e mallrave të akcizës nën pezullim tatimor, qofshin këto ngarkesa tregtare apo të tjera, të cilat udhëtojnë nga pika e importit për në magazinën tatimore në Shqipëri ose nga një magazinë tatimore tek një tjetër brenda Shqipërisë, dhe që janë nën pronësinë dhe administrimin e të njëjtit person, kur këto ngarkesa janë më të vogla, se ato që paraqiten në dokumentin e lëvizjes në momentin e dorëzimit, atëherë duhet nisur menjëherë një investigim.

24.2 Investigimi duhet të përfshijë stafin që punon në magazinën tatimore pritëse, stafin që punon në vendin e nisjes dhe personin përgjegjës për transportimin e mallit. Në rastet kur sasia e marrë është më e vogël, se ajo e deklaruar në dokumentin e lëvizjes, investigimi duhet të përcaktojë nëse humbja ka ndodhur për shkak të ndonjë aksidenti.

24.3 Për të mundësuar arritjen në një përfundim nga ana e degës së tatimeve, lidhur me pagesën apo jo të akcizës mbi humbjen, duhet të përgatitet një raport me shkrim mbi rrethanat e humbjes.

24.4 Pavarësisht nga pika 23 më lart, në rastet kur një ngarkesë e mallrave të akcizës nuk rivulohet (riplumboset) në doganë, importuesi i mallrave të akcizës është përgjegjës për akcizën mbi të gjitha humbjet e përcaktuara në nenin 13 të ligjit. Dega tatimore përkatëse vlerëson akcizën mbi sasinë e mallrave që kanë lidhje me humbjen.

25. Humbjet në prodhim dhe magazinim

Humbjet e zakonshme në procesin e prodhimit (diferenca midis produkteve përfundimtare me akcizë që janë prodhuar dhe sasisë maksimale teorike të produkteve përfundimtare me akcizë që mund të prodhohen nga lëndët e para të përdorura në proces), në ambalazhim (dëmtimet dhe humbjet) dhe magazinim (të tilla si avullimi i alkoolit), nuk tatohen me akcizë. Për shifrat e prodhimit faktik, të humbjes në prodhim dhe magazinim duhet të bihet dakord dhe këto të përfshihen në miratimin dhe autorizimin përkatës që i jepet personit për magazinën tatimore. Megjithatë, në asnjë rrethanë humbja e miratuar nuk duhet të tejkalojë:

- për alkoolin dhe pijet alkoolike, 2 për qind të vëllimit që është parashikuar të prodhohet nga sasia e lëndëve të para që përdoren në prodhim dhe 2 për qind për ambalazhimin, që përfshin sasinë e lëngut të derdhur të mallrave të akcizës në procesin e ambalazhimit, ambalazhime të dëmtuara apo të mbushura me pak ose të avulluara;

- për pijet joalkoolike, që përfshihen në kodin NC 20 09 dhe 22 02, humbja maksimale është 2për qind e vëllimit që ishte parashikuar të prodhohej nga sasia e lëndëve të para të përdorura në prodhim;

- për cigaret, humbja maksimale është 2 për qind e sasisë së cigareve që ishte parashikuar të prodhoheshin nga sasia e lëndëve të para të përdorura në prodhim;

- për karburantin, humbja maksimale është 2 për qind e vëllimit që ishte parashikuar të prodhohej nga sasia e lëndëve të para të përdorura në prodhim dhe jo më shumë se 1 për qind e humbjeve në magazinim kur vëllimi përcaktohet sipas pikës 59 më poshtë.

Pavarësisht nga nivelet maksimale të renditura më lart në paragrafin 25.1, kur shkak i humbjes nuk mund të shpjegohet, për të gjitha humbjet e pashpjeguara paguhet akcizë.

Humbjet e pazakonta (çdo humbje e ndodhur papritur, siç janë plaçkitjet në magazinë, derdhjet, dëmtimet nga keqfunksionimi i makinerisë etj.) do t'i nënshtrohen një vlerësimi. Megjithatë, nëse humbja është e shpjegueshme mund të mos paguhet akcizë, por kjo humbje duhet të evidentohet dhe të mos jetë e vazhdueshme. Çdo person që ka marrë një vlerësim që rezulton nga humbja, mund të paraqesë një shpjegim me shkrim si pjesë e procesit të apelimit. Shpjegimi duhet të paraqesë evidencë që po merren të gjitha hapat e arsyeshme, që:

- a) të sigurojë gjatë ngarkimit, transportimit dhe shkarkimit mallrat e akcizës nën regjimin e pezullimit tatimor;

- b) të masë me saktësi sasinë e dala dhe të marra;

- c) të sigurojë mbledhjen dhe dhënien e të gjithë informacionit përkatës në lidhje me ndonjë incident, aksident apo gabim që dëmton mallrat e akcizës.

Shpjegimi që paraqet si shkak një humbje aksidentale nuk pranohet pa fakte të mjaftueshme vërtetuese.

Në rrethanat kur identifikohet një humbje e pazakontë dhe tatimpaguesi i akcizës do të kërkojë mospagimin e akcizës për humbjen, duhet që të bëhet një shënim në regjistrin e ciklit të prodhimit dhe regjistrin e mbetjeve në shtojcën 12, si dhe të raportohet humbja e pazakontë në shtojcën 13. Tatimpaguesit i duhet gjithashtu që, menjëherë pasi të jetë identifikuar humbja, të kontaktojnë degën tatimore përkatëse deri në fund të ditës pasardhëse të punës.

Raporti i humbjeve të pazakonta duhet të përfshijë datën dhe kohën kur është identifikuar humbja, datën dhe kohën kur është njoftuar punonjësi i degës tatimore, një shpjegim të plotë të shkakut të kësaj humbjeje, sasinë e vlerësuar të mallrave apo lëndëve të para që kanë humbur dhe masat që janë marrë për mospërsëritjen e saj.

26. Pagesa e tatimit për humbjet

Vlerësimi i akcizës për humbjet i lëshohet personit, që është përgjegjës për mallin e akcizës në kohën kur ka ndodhur humbja. Personi të cilit i është bërë vlerësimi mund të apelojë dhe të sigurojë fakte që humbja ndodhi për një arsye të ligjshme ose kur humbja ka ndodhur në momentin që mallrat nuk kanë qenë në zotërim të personit.

Një arsye e drejtë është kur humbja ndodh për shkaqe të natyrshme brenda proceseve operative apo dëmtimeve gjatë procesit të ambalazhimit në shishe ose për shkak të një aksidenti duke e bërë të pamundur konsumin e mallrave.

Të gjitha sasinë e humbura të mallrave të akcizës për shkak të tejmbushjes së vazhdueshme të tatohen me akcizë.

“Humbjet” e mallrave të akcizës, për shkak të vjedhjes ose plaçkitjes, nuk konsiderohen si humbje të pranuar. Kur një mall akcizë nën regjimin e pezullimit tatimor vidhet, personi i autorizuar që ka qenë në zotërim të mallit, duhet të paguajë akcizën mbi sasinë e mallrave të vjedhura.

27. Mostrat

Marrja e mostrave është e lejuar. Tatimpaguesi i autorizuar i akcizës mund të marrë sasi të prodhimit dhe mostra si referencë për t'i analizuar, por jo për konsum dhe në këtë rast sasia e prodhimit marrë si mostër përjashtohet nga akciza.

Të përjashtuara nga akciza janë vetëm mostrat që nuk konsumohen nga njerëzit. Të gjitha mostrat e tjera, siç janë mostrat tregtare që përdoren për qëllime tregtare ose promocionale, ose për provë janë të tatueshme me akcizë.

Tatimpaguesi i autorizuar i akcizës mund të marrë dhe të heqë mostra nga një proces prodhimi, proces ambalazhimi në shishe apo magazinimi pa paguar tatim për:

- kontrollat e cilësisë;
- qëllime reference;
- kërkime shkencore ose testim.

Një regjistër i veçantë i njohur si “Regjistri i mostrave” duhet të mbahet sipas formës dhe mënyrës në shtojcën 15 më poshtë.

Të gjitha mostrat që janë të përjashtuara nga tatimet duhet të klasifikohen me detaje që mund të rakordohen me regjistrin e mostrave. Madhësia e çdo mostre duhet të jetë minimumi i asaj që nevojitet për përdorimin e veçantë.

27.6 Pasi të jenë marrë mostrat, ato duhet të kthehen në mallin gjendje ose të shkatërrohen sipas procesit të përshkruar më poshtë në pikën 28.

28. Shkatërrimi i mallrave të akcizës që janë nën regjimin e pezullimit tatimor

28.1 Personi që mban mallrat e akcizës në magazinën e tij tatimore dhe që dëshiron t'i shkatërrojë ato, duhet të njoftojë punonjësin e degës tatimore në rreth për çdo lloj shkatërrimi brenda magazinës tatimore pesë ditë-pune më përpara (përjashtuar të shtunat, të dielat ose ditët e festave zyrtare) sipas njoftimit të formularit të shkatërrimit të mallrave të akcizës në shtojcën 16.

28.2 Organi tatimor mund të japë leje për shkatërrimin e mallrave të akcizës për të cilat akciza nuk është paguar nëse mallrat:

- janë të dëmtuara;
- rezultojnë më shumë pas operacioneve;
- rezultojnë mbetje;
- janë në kushte të patregtueshme.

28.3 Nga tatimpaguesi i autorizuar i akcizës nuk mund të bëhet shkatërrimi pa marrë fletën e “miratimit”. Organi tatimor do të kthejë pranimin pesë ditë-pune nga marrja e tij.

PJESA IX – PROCESET E PËRJASHTUARA DHE TË MIRATUARA

29. Proceset e miratuara nën regjimin e rimbursimit të akcizës

29.1 Proceset e miratuara të përcaktuara në nenin 19(2)(a) janë:

- a) prodhimi i produkteve të pranuar mjekësore të miratuara nga organi tatimor dhe që i nënshtrohen procedurave të pikës 30 më poshtë;
- b) prodhimi i uthullës. që i nënshtrohet procedurave në pikën 31 më poshtë;
- c) prodhimi për tregtim i mallrave ushqimore duke përdorur pije alkoolike;
- ç) përdorimi i karburantit për motorët e anijeve të peshkimit;
- d) prodhimi i alkoolit të denaturuar që i nënshtrohet procedurave të pikës 32 dhe 33 më poshtë.

29.2 Akciza e paguar mbi mallrat, të cilat janë përdorur në proceset e miratuara më lart, jashtë magazinës tatimore, mund të bëhet objekt i një kërkesë për rimbursim.

29.3 Sipas dispozitave të kësaj pjese, kur një person i vërteton organit tatimor që:

- a) çdo sasi alkooli e tatueshme, për të cilën është paguar akcizë, është përdorur në një proces të miratuar në pikën 29.1 më lart, ai person ka të drejtë të bëjë kërkesë në organin tatimor për rimbursimin e akcizës së paguar mbi mallrat përkatëse të akcizës të përdorura në prodhimin e atij produkti;

b) çdo sasi e tatueshme karburanti, për të cilën është paguar akcizë, është përdorur në motorin e një anijeje tregtare peshkimi për udhëtime për peshkim, ai mund të bëjë kërkesë në organin tatimor për rimbursimin e akcizës së paguar për karburantin e përdorur gjatë udhëtimeve të peshkimit.

29.4 Rimbursimi i akcizës në lidhje me ndonjë sasi alkooli ose karburanti nuk duhet bërë, përveçse ndaj një personi i cili:

a) është personi që ka përdorur alkoolin ose pijen alkoolike në një proces të miratuar të specifikuar në paragrafin 29.1 më lart dhe kryen një biznes si furnizues produktesh të renditura në paragrafin 29.1 më lart, të cilat nxirren ose prodhohen për qëllimet e atij biznesi;

b) është organizata e menaxhimit të peshkimit e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, për akcizën e paguar për karburantin e furnizuar personave që zotërojnë anije tregtare peshkimi, që përdoren vetëm për udhëtime peshkimi.

Çdo person që blen mallra akcize që do të përdoren në një proces të miratuar, duhet të sigurohet që fatura të përfshijë:

një numër serial vijues;

a) sasinë dhe llojin a mallrave të blera të akcizës;

b) detyrimin e akcizës mbi ngarkesën.

Rimbursimi do të bëhet vetëm kur mund të verifikohet evidenca e përdorimit të mallrave të akcizës në procesin e miratuar dhe të jetë paguar akciza që kërkohet nga rimbursimi. Çdo person që dorëzon një kërkesë për rimbursim të tatimit të akcizës së paguar mbi mallrat, që janë përdorur në një proces të miratuar, duhet të mbajë të dhënat e mëposhtme (përveç të dhënave të zakonshme tregtare) dhe t'i dorëzojë ato sa herë që kërkohen nga organi tatimor:

a. regjistrimet e alkoolit të marrë dhe të përdorur;

b. faturat që tregojnë shumën e akcizës së paguar për mallrat;

c. për një rimbursim të karburantit të përdorur në peshkim, duhet të paraqiten të dhënat sipas paragrafëve 29.7 dhe 29.8 më poshtë.

Në rastet kur karburanti përdoret në motorin e anijes tregtare të peshkimit gjatë një udhëtimi për peshkim, rimbursimi do të kryhet vetëm pasi të evidentohet një përdorim i tillë, siç përshkruhet në paragrafin 29.8 më poshtë dhe furnizimi i karburantit, veprimtaria e peshkimit dhe veprime të tjera të jenë konform vendimit të Këshillit të Ministrave. Për qëllimin e këtij udhëzimi, një udhëtim për qëllime tregtare peshkimi nënkupton një udhëtim që kryhet nga një shoqëri peshkimi me qëllim zënien e peshkut për shitje.

Organizata e Menaxhimit të Peshkimit që bën kërkesë për rimbursimin e akcizës së paguar për karburantin e përdorur në motorin e një anijeje peshkimi gjatë një udhëtimi për peshkim, duhet të mbajë të dhënat e mëposhtme dhe t'ia paraqesë ato organeve tatimore sa herë që nevojitet:

a) detaje për sasinë e karburantit të përdorur për udhëtime tregtare peshkimi;

b) detaje për sasinë e karburantit që i furnizohet çdo anije tregtare peshkimi;

c) numrat e regjistrimit të të gjitha anijeve tregtare të peshkimit me të cilat ka të bëjë kërkesa për rimbursim;

d) faturat e furnizimit me karburant të anijeve të peshkimit, që tregojnë numrin e regjistrimit të çdo anijeje;

e) fatura e blerjes së karburantit që tregon veçmas detyrimin e akcizës për karburantin e blerë;

f) ditari i udhëtimit të anijes tregtare të peshkimit që tregon orarin e nisjes dhe kthimit në port, qëllimin e udhëtimit dhe vendin ku është kryer peshkimi.

Kërkesa për rimbursim duhet të bëhet në periudha kalendarike tremujore, në degën e tatimeve ku është i regjistruar kërkuesi duke përdorur formularin e paraqitur në shtojcën 22 të këtij udhëzimi.

29.10 Pas marrjes së kërkesës për rimbursim së bashku me dokumentet mbështetëse, dega e tatimeve, nëse bindet, do të marrë masa për miratimin e rimbursimit, që do të paguhet brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, përveçse në rastet kur kërkesa i nënshtrohet një investigimi të mëtejshëm për të verifikuar vërtetësinë e saj.

30. Produktet e njohura mjekësore

Një prodhues i produkteve të njohura mjekësore duhet të jetë një shoqëri farmaceutike, interesi kryesor i biznesit të së cilës është prodhimi i produkteve të njohura mjekësore.

Një produkt i njohur mjekësor është ai produkt me cilësi mjekësore të njohura dhe i verifikuar nga Ministria e Shëndetësisë. Për qëllimet e këtij udhëzimi, ilaçet herbale dhe homeopatike nuk konsiderohen si produkte mjekësore të njohura.

Regjistrimet e ambalazheve dhe shpërndarjes së prodhimit siç paraqiten në pikën 17 dhe shtojcën 7, shtojcën 8 dhe shtojcën 9 të këtij udhëzimi duhet të mbahen në formë të tillë që tregojnë sasinë e alkoolit të marrë dhe të përdorur për prodhimin e produkteve mjekësore.

31. Prodhimi i uthullës

Uthulla që klasifikohet sipas kodit të nomenklaturës doganore 22.09 është e përjashtuar nga akciza.

31.2 Tatimpaguesi i autorizuar i akcizës që prodhon uthull duhet të mbajë të dhënat e ambalazhimit dhe shpërndarjes së mallrave të akcizës përfshirë të dhënat për uthullën, të renditura më lart në pikën 17 dhe shtojcën 7, shtojcën 8 dhe shtojcën 9 të këtij udhëzimi, si dhe të plotësojë të gjitha kushtet e miratimit të magazinës tatimore.

PJESA X – ALKOOLI I DENATYRUAR

Përkufizimi i alkoolit të denatyrar

32.1 Alkooli denatyrohet kur i shtohen kimikate ose substanca të tjera që nuk pihen, me qëllim që ta bëjnë atë të papijshëm.

32.2 Kategoritë e alkoolit të denatyrar që njihen në Republikën e Shqipërisë si alkool i denatyrar, dhe si rrjedhojë përjashtohen nga tatimi i akcizës në vendin e importit, janë renditur në pikat 32.3 deri 32.8 në vijim, si dhe përbërjet jostandarde të alkoolit të denatyrar të miratuar sipas pikës 33.4 më poshtë.

32.3 Kategoritë e alkoolit të denatyrar janë:

- a) Alkool krejtësisht i denatyrar;
- b) Alkool pjesërisht i denatyrar;
- c) Alkool i denatyrar në ambientet tregtare.

32.4 Formulimi standard i alkoolit të krejtësisht të denatyrar është:

- 90 pjesë të vëllimit të pijeve alkoolike;
- 9.5 pjesë të vëllimit të vajgurit drusor;
- 0.5 pjesë të vëllimit të piridinës së papërpunuar që shtohet për çdo 1 000 litra
- 3.75 litra të mineralit vajguror (naftë);
- 1.5 gram të metilit bojëvjollcë.

Në rastet kur nuk mund të përdoret alkooli krejtësisht i denatyrar, në vend të tij mund të përdoret ai pjesërisht i denatyrar në përbërjen e mëposhtme:

- 95 pjesë të vëllimit të pijeve alkoolike;
- 5 pjesë të vëllimit të vajgurit drusor.

32.6 Alkool pjesërisht i denatyrar mund të përdoret në:

- a) prodhimin e ndonjë artikulli që në trajtën e tij përfundimtare nuk përmban lëndë alkoolike;
- b) prodhimin e produkteve mjekësore, veterinare dhe farmaceutike vetëm për përdorim të jashtëm;
- c) procese pastrimi industriale ose komerciale.

32.7 Përbërje alkooli të denatyrar, veçanërisht për tregti, mund të përdoren në prodhimin e artikujve kosmetikë dhe parfumeve në përbërjet e mëposhtme:

- 999 pjesë të vëllimit të pijeve alkoolike (të një fortësie jo më pak se 85 për qind e vëllimit);
- 1 pjesë e vëllimit të alkoolit butil tretësor, të cilit i shtohet 10 mikrogramë bitreks për mililitër.

Prodhimi i alkoolit të denatyrar

Alkooli i denatyrar që përfshihet në përkufizimet e pikës 32 më lart ose përputhet me formulën e miratuar nga organi tatimor sipas paragrafit 33.5 më poshtë është i përjashtuar nga akciza.

Regjistrimet e ambalazhimit dhe shpërndarjes së prodhimit siç tregohen në pikën 17 dhe shtojcën 7, shtojcën 8 dhe shtojcën 9 të këtij udhëzimi duhet të mbahen duke treguar sasinë e alkoolit

të marrë dhe të përdorur në prodhimin e alkoolit të denatyrar.

Vetëm sasi të e alkoolit të përdorur në ato formulime të alkoolit të denatyrar që miratohen nga organi tatimor janë të pranueshme për rimbursim.

Përbërje të ndryshme dhe receta kimikatesh dhe substancash të tjera mund të përdoren për qëllime të ndryshme. Një prodhues mund të bëjë kërkesë në degën e tatimeve për të marrë leje për përdorimin e një formule jostandarde alkooli të denatyrar në rrethanat kur përbërjet standarde nuk janë të përshtatshme.

Për të bërë kërkesë për një formulë jostandarde alkooli të denatyrar, prodhuesi i alkoolit të denatyrar duhet t'i paraqesë një kërkesë me shkrim degës së tatimeve, duke i dhënë një përshkrim të përbërjes së re, arsyen pse nuk mund të përdoren formulimet në autorizimin ekzistues dhe një mostër të alkoolit të denatyrar për t'u testuar nga Instituti i Teknologjisë Ushqimore.

Pas këshillimit me Institutin e Teknologjisë Ushqimore, dega e tatimeve do të vendosë nëse përbërja e re mund të prodhohet.

Prodhuesi i alkoolit të denatyrar, që përdor një formulë jostandarde nuk mund të aplikojë për rimbursim, përderisa formula jostandarde të jetë miratuar me shkrim.

Dispozitat e këtij udhëzimi, që lidhen me rimbursimin, nuk zbatohen në rastet kur alkooli i denatyrar është prodhuar në të njëjtën magazinë tatimore ku është prodhuar alkooli natyral.

PJESA XI - KOHA DHE METODA E PAGESËS SË AKCIZËS PËR MALLRAT QË TREGTOHEN PA PULLË

34. Momenti i bërjes së deklaratës dhe pagesës

Dispozitat e kësaj pjese zbatohen për deklaratën dhe pagesën e akcizës për mallrat që tregtohen pa pullë akcize. Këto dispozita nuk zbatohen mbi mallrat e akcizës të importuara për të cilat akciza i paguhet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Çdo person që duhet të paguajë çfarëdolloj shume akcize gjatë një periudhe tatimore apo që kërkon rimbursimin e akcizës për një periudhë tatimore, duhet që, në çdo periudhë tatimore, të dorëzojë një deklaratë.

Deklarata duhet të jetë në formën e përcaktuar në shtojcën 17 dhe duhet të firmoset nga një nënshkrues i autorizuar, që konfirmon se informacioni i dhënë është i vërtetë dhe i plotë.

Për qëllimet e këtyre dispozitave, periudha tatimore është muaji kalendarik.

Deklarata plotësohet dhe paraqitet në dy kopje dhe pagesa bëhet nga tatimpaguesi i autorizuar i akcizës ose një nënshkrues i autorizuar në filialin e bankës përkatëse, e cila ka një marrëveshje me organin tatimor për pranimin e pagesave në lidhje me akcizën.

Deklarata duhet të paraqitet dhe tatimi duhet të paguhet në bankë në rrethin ku gjendet magazina tatimore e miratuar, jo më vonë se data 15 e çdo muaji për muajin (periudhën tatimore) paraardhës. Ditët e pushimit ose festat nuk njihen për efekt të respektimit të datës së mësipërme, prandaj, në raste të tilla, tatimpaguesi duhet të marrë masa të kryejë pagesën më përpara (pra jo më vonë se dita e fundit e punës përpara datës 15).

Për qëllimet e këtyre dispozitave, “ditë-pune” nënkupton ditën kur banka është e hapur.

Punonjësi i bankës plotëson pjesën e deklaratës që titullohet “Pagesa” dhe pastaj ia kthen kopjen e dytë tatimpaguesit të autorizuar të akcizës.

Në fund të çdo dite, kopjet origjinale të deklaratave të dorëzuara në bankë duhet t'i dërgohen degës së tatimeve për përpunim, siç përcaktohet nga marrëveshjet me bankat përkatëse.

34.10 Dorëzimi në bankë i deklaratave për detyrime “zero” nga tatimpaguesi i akcizës dhe përpunimi sipas këtij udhëzimi është i detyrueshëm.

34.11 Për çdo magazinë tatimore të miratuar sipas këtij udhëzimi, duhet një deklaratë e veçantë.

PJESA XII – PULLAT E AKCIZËS

35. Pullat e akcizës - Përgjithësim

Për pijet alkoolike (përveç birrës) dhe për cigaret, akciza paguhet me anë të blerjes së pullave të akcizës siç përcaktohet në nenin 24 të ligjit.

Organi tatimor është përgjegjës për printimin, kontrollin dhe lëshimin e pullave të akcizës në Republikën e Shqipërisë dhe për çdo lloj malli akcizë me pullë duhet të prodhojë lloje unike pullash akcize.

Dispozitat e mëposhtme të përkohshme do të zbatohen ditën e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi dhe në çdo datë vijuese kur do të hyjë në fuqi një nivel i ri i akcizës për mallrat e akcizës me pullë:

a) Mallrat e akcizës të prodhuara ose ambalazhuara në Shqipëri duhet të kenë të ngjitura pulla akcize me nivelin tatimor, që është në fuqi ditën kur pulla e akcizës është vendosur mbi paketën apo njësinë ambalazhuese me pakicë.

b) Mallrat e akcizës të importuara në Shqipëri duhet të kenë të fiksuar pullat me nivelin tatimor të akcizës, që është në fuqi ditën kur mallrat deklarohen në doganë.

c) Kur mallrat e akcizës, që kërkojnë pullë importohen në Shqipëri me pulla të ngjitura që përmbajnë një normë tatimore më të ulët, sesa ajo në fuqi në momentin e importit, diferenca ndërmjet normës tatimore dhe akcizës së paguar me anë të blerjes së pullave të akcizës deklarohet dhe paguhet në organet tatimore. Për këtë tatimpaguesi duhet të ketë bërë pagesën dhe kjo t'i jetë konfirmuar degës tatimore nga filiali i bankës së miratuar. Nga ana e doganës, zhdoganimi i mallrave bëhet vetëm pasi ajo të ketë marrë njoftimin nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve se tatimpaguesi ka bërë pagesën e duhur.

36. Përmbajtja dhe forma e pullave të akcizës

Përmbajtja dhe dizeno (forma) e çdo pulle do të bëjë dallimin midis llojit dhe sasisë së mallrave të akcizës, si dhe detyrimin tatimor përkatës për çdo lloj malli akcizë, të cilit i vendoset pullë.

Në rastet kur cigaret shiten në paketa që mbajnë më tepër se 20 cigare, akciza llogaritet përpjestimisht duke përdorur formulën: niveli i akcizës për çdo paketë me 20 cigare në tabelën 1 të ligjit, e pjesëtuar me 20 dhe shumëzuar me numrin e cigareve në paketën përkatëse dhe pulla do të ketë të shënuar numrin e cigareve në paketë.

Pa cenuar dispozitat e paragrafit 36.1 më lart, pijet alkoolike të ambalazuara në njësi ambalazhimi me përmasa prej 5cl ose më pak, nuk pajisen me pulla akcize. Akciza duhet të llogaritet mbi njësi të ambalazuara sipas dispozitave të pjesës XI të këtij udhëzimi.

Pulla e akcizës duhet të ngjitet në mënyrën e miratuar në miratimin përkatës të magazinës tatimore.

37. Shtypshkronja e autorizuar për prodhimin dhe inspektori i autorizuar për kontrollin e pullave

Pullat e akcizës mund të printohen vetëm nga një person i autorizuar me shkrim nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, si shtypshkronja e autorizuar për shtypjen e pullave dhe organi tatimor do të lidhë një kontratë me shtypshkronjën e autorizuar duke përcaktuar kërkesat e tij, përfshirë paraqitjen e jashtme dhe përmbajtjen e çdo lloji pulle akcize.

Shtypshkronja e autorizuar duhet të emërojë një nëpunës të lartë të personelit të saj në rolin e drejtuesit ndërlidhës për pullat e akcizës duke njoftuar emrin e këtij të fundit, si dhe të dërgojë me shkrim një mostër të firmës së drejtuesit ndërlidhës për pullat e akcizës.

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve autorizon një punonjës të organit tatimor në rolin e “Inspektorit të kontrollit të pullave të akcizës (inspektori i pullave)”, njofton emrin e tij në shtypshkronjën e autorizuar duke i dërguar kësaj të fundit mostrën e firmës së inspektorit. Urdhri për shtypjen dhe shpërndarjen e pullave të akcizës sipas dispozitave të këtij udhëzimi, është kompetencë e inspektorit të pullave ose e një zëvendësdrejtori të përgjithshëm, persona që gjithashtu kanë kompetencat e inspektorit të pullave.

Porositja e pullave të akcizës nga organi tatimor

Shtypja e pullave të akcizës do të autorizohet nga inspektori i kontrollit të pullave të akcizës me anë të formularit të autorizimit bashkëngjitur kontratës së përfunduar me shtypshkronjën e autorizuar, dhe kjo e fundit duhet të shtypë dhe ruajë vetëm sasisë e porositura.

Formulari i autorizimit të shtypjes duhet të plotësohet në tri kopje, kopja e parë duhet të mbahet nga inspektori i pullave dhe porositja të dërgohet në shtypshkronjën e autorizuar së bashku me kopjen e dytë. Shtypshkronja e autorizuar do të firmosë dhe do të kthejë një kopje të formularit të

autorizimit si konfirmim për shtypjen e kërkuar dhe marrëveshjes për kryerjen e shtypjes sipas kontratës, duke mbajtur kopjen e tretë në dokumentacionin e saj.

39. Shtypja e pullave të akcizës nga shtypshkronja e autorizuar

Shtypshkronja e autorizuar shtyp pullat e akcizës sipas porosisë së bërë nga inspektori i pullave sipas pikës 38 më lart dhe specifikave të përcaktuara në kontratën e lidhur me organin tatimor dhe hedh në një regjistër detajet për të gjitha pullat e akcizës në formën dhe përmbajtjen, siç përshkruhet në kontratën me shtypshkronjën e autorizuar.

Të gjitha pullat e akcizës që janë të dëmtuara ose janë bërë të papërdorshme gjatë prodhimit, regjistrohen në formën dhe mënyrën e paraqitur në kontratën me shtypshkronjën e autorizuar dhe ruhen për inspektim nga inspektori i kontrollit të pullave të akcizës, i cili do të autorizojë shkatërrimin pasi t'i ketë inspektuar.

40. Ruajtja dhe regjistrimi i pullave të akcizës pas shtypjes

Në fund të çdo cikli shtypjeje, pullat e akcizës dërgohen menjëherë në një hapësirë të sigurt magazinimi, që kyçet ose sigurohet dhe drejtuesi i ndërlidhjes për pullat e akcizës nuk lejon hyrjen e askujt, përveçse në rastet kur pullave të akcizës u bëhet hyrje ose dalje nga magazina.

Hyrja në magazinë lejohet vetëm për mbajtësin e autorizuar të çelësave të caktuar nga drejtuesi i ndërlidhjes.

Sasia e çdo lloj pulle akcize të vendosur në ambient të sigurt duhet të regjistrohet në formën dhe mënyrën e paraqitur në kontratën me shtypshkronjën e autorizuar.

Shtypshkronja e autorizuar duhet të paraqesë një deklaratë të gjendjes së pullave të shtypura që ka të magazinuara dhe ato që i ka dërguar inspektorit të akcizës deri më datë 15 të muajit që vijon pas muajit të cilit i referohet raporti, me anë të formularit, forma dhe mënyra e të cilit paraqitet në kontratën me shtypshkronjën e autorizuar.

41. Furnizimi i pullave të akcizës nga shtypshkronja e autorizuar tek inspektori i kontrollit të pullave.

Inspektori për kontrollin e pullave të akcizës duhet të porosisë dërgimin e pullave të shtypura të akcizës nga shtypshkronja e autorizuar sipas formularit të dërgimit të pullave, përshkruar në kontratën me shtypshkronjën e autorizuar dhe nga magazina e shtypshkronjës së autorizuar nxirret vetëm sasia e pullave të porositura të akcizës.

Pullat e akcizës konsiderohen si të dërguara nga shtypshkronja e autorizuar kur ato kalojnë në ngarkim të inspektorit të kontrollit të pullave të akcizës.

Formulari i dërgimit të pullave të akcizës plotësohet në tri kopje, kopja e parë mbahet nga inspektori i kontrollit të pullave të akcizës dhe dërgesa së bashku me kopjen e dytë dhe të tretë gjenden tek shtypshkronja e autorizuar. Shtypshkronja e autorizuar firmos dhe kthen formularin e dërgimit si konfirmim për pullat e akcizës që janë dërguar, duke mbajtur kopjen e tretë në dokumentacionin e saj.

Autorizimi për dërgimin, personat e autorizuar për të bërë transportimin për çdo porosi nga shtypshkronja e autorizuar dhe mënyra e dërgimit përshkruhen në kontratën me shtypshkronjën e autorizuar.

Shtypshkronja e autorizuar duhet të mbajë një regjistër në formën dhe mënyrën e përshkruar në kontratën me organin tatimor ku paraqitet:

- data e lëshimit të pullave të akcizës;
- sasia e çdo lloj pulle akcize të emetuar;
- emri i përfaqësuesit të shtypshkronjës së autorizuar dhe i përfaqësuesit të administratës tatimore që është i pranishëm në momentin e livrimit dhe sipas rastit,
- numrin serial të çdo lloji pulle akcize të emetuar.

41.6 Sasia e verifikuar e çdo lloji të pullave të akcizës duhet të transportohet menjëherë në DPT dhe të vendoset në një ambient të sigurt magazinimi.

42. Marrja në dorëzim dhe magazinimi i pullave të akcizës në zyrat qendrore të organit tatimor

Pas marrjes në dorëzim të pullave të akcizës nga inspektori i kontrollit, lloji dhe sasia e pullave të akcizës duhet verifikuar kundrejt formularit të përcaktuar sipas pikës 41 më lart dhe kur sasia është e saktë, formulari firmoset nga inspektori i kontrollit të pullave dhe skedohet.

Çdo mospërputhje ndërmjet pullave të porositura të akcizës dhe atyre të dërguara duhet të paraqitet menjëherë përpara Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, përgjegjësit të kontrollit të brendshëm dhe drejtuesit ndërlidhës të autorizuar për pullat e akcizës. Për të përcaktuar shkakun duhet nisur një investigim dhe përgjegjësi i kontrollit të brendshëm duhet të përgatisë një raport me shkrim.

Pullat e akcizës mund të mbahen vetëm në një ambient të sigurt që mbahet i kyçur me çelës brenda ambienteve të zyrave qendrore të organit tatimor.

Në ambientin e magazinimit mund të hyjë vetëm inspektori i kontrollit të pullave të akcizës dhe hapja e derës së magazinës, si dhe arsyeja për hapjen e saj në çdo rast duhet të regjistrohen.

43. Të dhënat që duhet të mbajë inspektori i kontrollit të pullave të akcizës

Të dhënat e magazinimit dhe shpërndarjes së pullave të akcizës duhet të mbahen dhe të ruhen nga inspektori i kontrollit të pullave të akcizës në baza ditore.

Në fund të çdo muaji kalendarik, për çdo lloj pulle të akcizës, inspektori i kontrollit të pullave të akcizës duhet të bëjë një përmbledhje të të gjitha hyrjeve dhe daljeve të pullave të akcizës në zyrat qendrore të organit tatimor. Për çdo lloj pulle të akcizës, regjistri duhet të tregojë sasinë e pullave të akcizës:

- a) gjendje në ditën e fundit të punës të çdo muaji kalendarik;
- b) të marra (të bëra hyrje) çdo muaj kalendarik sipas llojit të pullës së akcizës dhe numrit serial;
- c) të furnizuara (të shitura), kujt i janë shitur dhe numrat serialë.

44. Kërkesa për pulla akcize nga një tatimpagues i autorizuar akcize

Kërkesë për blerje pulla akcize në Republikën e Shqipërisë mund të bëjnë vetëm personat e autorizuar nga organi tatimor si tatimpagues të autorizuar akcize që prodhojnë apo importojnë mallra akcize ose përfaqësuesit fiskalë të caktuar sipas neneve 4 dhe 7 të ligjit.

Kur pullat e akcizës janë për mallra që do të importohen në Shqipëri, kërkesa duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

- a) emrin dhe adresën e personit jashtë vendit ku do të dërgohen pullat e akcizës;
- b) një përshkrim i mallrave në të cilat do të ngjiten pullat e akcizave përfshi dhe madhësinë e kontenerit;
- c) datën e parashikuar të dërgimit të mallrave për në Republikën e Shqipërisë.

Personi i autorizuar duhet të plotësojë formularin e porosisë së pullave sipas shtojcës 18 dhe të bëjë pagesën në filialin e bankës së rrethit. Pas marrjes së pagesës së kostos së pullave dhe akcizës që tregohen në formularin e porosisë, punonjësi i bankës duhet të plotësojë pjesën e formularit të titulluar “Pagesa” me shumën e marrë, në të tri kopjet, dhe t’i kthejë kopjen e dytë dhe të tretë tatimpaguesit të autorizuar të akcizës si vërtetim i pagesës.

Kopja e parë e formularit të porosisë i dërgohet degës së tatimeve çdo ditë në përputhje me marrëveshjen ndërmjet organit tatimor dhe bankës përkatëse.

Tatimpaguesi merr kopjen e dytë dhe të tretë të formularit të porosisë dhe ia jep inspektorit përgjegjës për kontrollin e magazinës tatimore në degën e tatimeve në rastet kur pullat do të përdoren ose, nëse është përfaqësuesi tatimor, në degën e tatimeve përgjegjëse për lëshimin e autorizimit.

Dega e tatimeve krahason kopjen e parë të marrë nga banka me kopjen e dytë dhe të tretë të formularit të porosisë dhe pagesën në të holla të raportuar dhe kur bindet se pagesa e regjistruar është e saktë, duhet të vërtetojë dhe të vendosë një numër serial (rendor) në të tri kopjet. Dega e tatimeve mban kopjen e tretë në dosjen e tatimpaguesit, duke bërë regjistrimet përkatëse dhe ia kthen kopjen e dytë personit të autorizuar dhe ia dërgon konfirmimin e porosisë dhe pagesës inspektorit të pullave duke i firmosur dhe dërguar kopjen e parë të formularit të porosisë.

Dhënia e çfarëdolloj sasive, të cilitdo tipi pulle akcize nuk do të bëhet për sa kohë nuk është bërë pagesa dhe kjo t’i jetë konfirmuar degës tatimore nga filiali i bankës së miratuar.

45. Pagesa e akcizës dhe e kostove të pullës

45.1 Pagesa e bërë duhet të mbulojë kostot e shtypjes së pullave të akcizës dhe shumën e akcizës në lidhje me sasinë e blerë të pullave.

46. Furnizimi me pulla akcize i tatimpaguesit të akcizës ose përfaqësuesit tatimor të autorizuar

Furnizimi me pulla akcize i një tatimpaguesi akcize ose përfaqësuesi tatimor të autorizuar bëhet vetëm nga inspektori i pullave të akcizës.

Tatimpaguesi i autorizuar i akcizës ose përfaqësuesi tatimor duhet të paraqiten në zyrat qendrore të organit tatimor për të marrë në dorëzim pullat e porositura të akcizës me të cilat do të furnizohen kundrejt kopjes së konfirmuar të formularit të kërkesës. Paraqitja duhet bërë pasi të jetë caktuar data e takimit, dhe në datën kur caktohet paraqitja e tatimpaguesit, ai duhet të përmendë numrin serial të formularit të porosisë që i referohet tërheqjes dhe pastaj t'i dorëzojë kopjen e dytë inspektorit të kontrollit për pullat e akcizës.

Pas marrjes së kopjes së dytë të formularit të kërkesës, inspektori i kontrollit të pullave të akcizës duhet ta krahasojë me të dhënat e kopjes së parë të formularit të kërkesës të marrë nga dega e tatimeve dhe të sigurohet që:

- a) aplikanti është një tatimpagues akcizë i autorizuar ose një përfaqësues tatimor;
- b) tipi i pullave lidhet me produktet për të cilat është autorizuar aplikanti;
- c) sasia e pullave të konsiderohet normale krahasuar me porositë e mëparshme dhe në të njëjtën linjë me procedurat me të cilat operon aplikanti;

a) të vërtetohet bërja e pagesës në degën e tatimeve;

b) pagesa të jetë e mjaftueshme për të mbuluar akcizën dhe koston e pullave të porositura.

46.4 Në kopjen e parë të formularit të kërkesës dhe në regjistrin e pullave gjendje të inspektorit të kontrollit të pullave të akcizës do të shënohet dorëzimi i pullave të akcizës tatimpaguesit të autorizuar të akcizës.

47. Të dhënat që kërkohen nga tatimpaguesi i autorizuar i akcizës ose një përfaqësues tatimor

Pasi pullat e akcizës i janë dorëzuar tatimpaguesit të autorizuar të akcizës:

- a) ato duhet të dërgohen sa më shpejt në magazinën tatimore ku do të përdoren;
- b) duhet të ruhen në një vend të sigurt të caktuar në miratimin e magazinës tatimore;
- c) kur nuk është në përdorim, hapësira e magazinimit duhet të jetë gjithmonë e kyçur dhe hyrja në ambientet e magazinimit lejohet vetëm për mbajtësit e autorizuar të çelësave;
- ç) duhen mbajtur të dhëna sipas formularit në shtojcën 19 që të tregojnë:
 - i) numrin serial dhe llojin e pullës së blerë;
 - ii) datën e mbërritjes;
 - iii) degën e tatimeve nga e cila u blenë pullat e akcizës;
 - iv) ciklin e prodhimit për të cilin u lëshuan pullat e akcizës dhe numrat e tyre serialë.

Kur i furnizuar me pulla akcize është një përfaqësues tatimor, pullat duhet të dërgohen pa vonesë në ambientet e prodhimit ku do të përdoren dhe për to mbahet një regjistër sipas paragrafit 44.2 më lart.

Tatimpaguesi i akcizës dhe përfaqësuesi tatimor i autorizuar duhet të mbajë sipas kërkesës së degës së tatimeve një kopje të formularit të porosisë që tregon pagesën e akcizës dhe verifikimin e kësaj të fundit nga dega e tatimeve.

48. Deklarata e pullave të akcizës

Jo më vonë se data 15 e çdo muaji kalendarik, tatimpaguesi i autorizuar i akcizës që prodhon mallra akcize me pullë ose përfaqësuesi tatimor përkatës i një importuesi mallrash akcize që kërkon pulla akcize, përgatit dhe dorëzon deklaratën në degën e tatimeve që e mbulon, sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar në shtojcën 20 të këtij udhëzimi.

Ngjitja e pullave të akcizës në paketa

Pullat e akcizës duhet të ngjiten në njësinë e ambalazhuar sipas nenit 25(3) të ligjit.

Në rastin kur pullat e akcizës ngjiten me dorë ose me makineri, duhet që:

- lloji i ngjitësit të përdorur të jetë i një standardi të miratuar, siç përcaktohet në miratimin e magazinës tatimore;

- pullat e akcizës të ngjiten në atë mënyrë që të bëhen të papërdorshme pas hapjes së paketës ose njësisë së ambalazhuar.

Në magazinën tatimore ku ngjiten pullat e akcizës duhet të zbatohen procedurat e kontrollit të cilësisë, me anë të të cilave kontrollohet nëse janë zbatuar kërkesat e ngjitjes së pullave, dhe në rastet kur pulla e akcizës nuk është ngjitur si duhet, ajo duhet të zëvendësohet.

Në rastin kur pullat e akcizës ngjiten në një njësi të ambalazhuar ose paketë duke përdorur një makineri, makineria duhet të miratohet dhe përfshihet si pjesë e miratimit përkatës të magazinës tatimore.

Rimbursimi i akcizës

Në rastet kur çfarëdolloj sasi e pullave të akcizës shkatërrohet ose bëhet e papërdorshme përpara ngjitjes së tyre, ose gjatë procesit të ngjitjes, kur ngjitet me makinë, ose bëhen të pavlefshme nga ndryshimi i nivelit të akcizës, mund të kërkohej rimbursimi i tatimit të akcizës.

Rimbursimi i tatimit të akcizës lejohet vetëm në rrethanat kur:

- a) personi që bën kërkesën është personi që ka blerë pullat e akcizës;
- b) pullat e dëmtuara ose të papërdorshme të akcizës i kthehen degës së tatimeve;
- c) sigurohet konfirmimi i pagesës së akcizës në lidhje me pullat e akcizës.

Konfirmimi i pagesës sipas paragrafit 50.2 më lart nënkupton një kopje origjinale të vërtetuar të formularit të porosisë që lidhet me pullat e akcizës të dëmtuara ose të papërdorshme.

Rimbursimi nuk lejohet kur rezulton se pulla e akcizës është vënë në mënyrë të rregullt dhe është grisur nga mënyra e hapjes së njësisë së ambalazhuar ose kur pullat e akcizës kanë humbur ose janë vjedhur.

Kostoja e shtypjes së pullave të akcizës që është objekt i kërkesës për rimbursim të akcizës nuk do të kthehet.

Për të bërë kërkesë për rimbursimin e akcizës, tatimpaguesi i autorizuar i akcizës ose përfaqësuesi tatimor duhet që:

- a) të plotësojë formularin e kërkesës për autorizimin e rimbursimit sipas shtojcës 21 të këtij udhëzimi;
- b) të kthejë pullat e akcizës në degën e tatimeve së bashku me kërkesën për rimbursim.

50.7 Dega e tatimeve do të verifikojë akcizën që është paguar dhe, nëse bindet se të gjitha kushtet për rimbursim janë plotësuar, do të konfirmojë rimbursimin e akcizës dhe do t'i kthejë aplikantit kopjen e dytë të autorizimit për rimbursim.

50.8 Tatimpaguesi i akcizës duhet të kompensojë rimbursimin kundrejt porosisë vijuese të pullave të akcizës, duke paraqitur autorizimin së bashku me formularin e porosisë së pullave të akcizës dhe porosia vijuese do të autorizohet me pagesën e akcizës neto.

50.9 Nëse tatimpaguesi i akcizës nuk kërkon furnizim të mëtejshëm me pulla akcize për gjashtë muaj në vijim të autorizimit apo rimbursimit, pas bërjes së kërkesës në degën e tatimore, akciza e paguar do t'i rimbursohet.

PJESA XIII – DEPOZITAT E KARBURANTIT

51. Të përgjithshme

Sipas dispozitave të ligjit dhe këtyre udhëzimeve, një depo karburanti është një magazinë tatimore dhe tatimpaguesi i autorizuar i akcizës përgjegjës për depon e karburantit duhet të zbatojë të gjitha dispozitat përkatëse të ligjit dhe të këtij udhëzimi për trajtimin e mallrave me akcizë pa pullë, përfshirë dispozitat në lidhje me lëvizjen e mallrave të akcizës në pjesën IV të këtij udhëzimi, në përputhje me dispozitat e pikave 52 dhe 54 më poshtë.

Një depo karburanti mund të furnizohet me ngarkesa karburanti të prodhuara në Republikën e Shqipërisë, nën regjimin e pezullimit tatimor, nga një rafineri e autorizuar si magazinë tatimore që është pronë dhe administrohet nga i njëjti operator.

Një depo karburanti nuk mund të magazinohet karburant të importuar nën regjimin e pezullimit tatimor.

Çisternat e magazinimit, të cilat furnizohen me karburant duhet të autorizohen si pjesë e miratimit të magazinës tatimore si depo karburanti.

52. Marrja e karburantit në depon e karburantit

Të paktën dy ditë përpara furnizimit (marrjes) të ndonjë sasi karburanti në një depo karburanti të autorizuar, administratori i depozitës së karburantit duhet të informojë degën e tatimeve të rrethit mbi synimin e tij për të marrë një ngarkesë me karburant, sipas formës së përcaktuar në shtojcën 5 të këtij udhëzimi.

53. Lëvizjet e tatueshme

Akciza në lidhje me mallrat (karburantin) që largohen nga depozita e karburantit, duhet të paguhet sipas dispozitave të pjesës XI të këtij udhëzimi.

54. Naftësjellësit

Karburantet nuk mund të merren ose të dërgohen me anë të një naftësjellësi që nuk është miratuar nga organi tatimor. Naftësjellësit duhet të miratohen si pjesë e miratimit të magazinës tatimore dhe duhet të kenë një pajisje matëse, e cila të masë me saktësi sasinë e karburantit që kalon nëpër pajisjen matëse.

PJESA XIV – PROCEDURA TË TJERA

55. Eksporte të pezulluara të mallrave me pullë akcize

Kur mallrat e akcizës që kërkohet të pajisen me pullë për shitje në Republikën e Shqipërisë, në rastet kur janë me destinacion për eksport, në bazë të dispozitave të këtij paragrafi dhe pikës 13 më lart, nuk është e nevojshme të pajisen me pullë akcize.

Mallrat e akcizës (që normalisht kërkohet të pajisen me pullë) mund të eksportohen pa i ngjitur pullat në magazinën tatimore nën regjimin e pezullimit tatimor në Republikën e Shqipërisë, vetëm nga tatimpagues të autorizuar të akcizës, në përputhje me dispozitat e kësaj pjese dhe duke siguruar një garanci financiare.

Për ato mallra të akcizës që janë për eksport nën regjimin e pezullimit tatimor nga një magazinë tatimore e miratuar, dega e tatimeve duhet të njoftohet për qëllimin e eksportit duke përdorur formularin në shtojcën 5 të paktën dy ditë përpara lëvizjes së mallrave të akcizës nga magazina tatimore.

Akciza mbi mallrat për eksport, mbetet detyrim për t'u paguar derisa eksportuesi të paraqesë provat e eksportimit.

Provat e eksportimit do të jenë:

a) një kopje e vërtetuar e dokumentit të lëvizjes sipas shtojcës 6, e firmosur nga doganieri verifikues në vendin ku është kryer eksporti;

b) një kopje e vërtetuar e dokumentacionit doganor të importit, që tregon se mallrat kanë mbërritur në vendin e importit dhe janë zhdoganuar në pikën e kontrollit doganor, pasi akciza të jetë paguar ose pasi kanë hyrë nën një regjim kontrolli doganor në atë vend.

Në rrethanat kur sasia e mallrave të akcizës e verifikuar si e importuar nga dogana ose e treguar si import në vendin e destinacionit është më e vogël se sasia e deklaruar për eksport, sipas nenit 14 të ligjit, shuma e akcizës, lidhur me diferencën e gjetur, do të vlerësohet dhe të paguhet nga tatimpaguesi.

55.7 Mallrat e akcizës që kërkojnë pulla akcize nuk lejohet të eksportohen nën skemën e rimbursimit të akcizës që është paraqitur më poshtë në pikën 57, pa u ngjitur pullat e akcizës.

56. Furnizimet në anije ose avionë

Furnizimet e mallrave të akcizës nën regjim pezullimi në anije ose avionë, sipas dispozitave të nenit 10(1)(c) të ligjit, mund të kryhen vetëm nga tatimpagues të autorizuar akcize që prodhojnë mallra akcize sipas dispozitave të këtij udhëzimi.

Çdo subjekt që operon si furnizues i pikave të shitjes në anije ose avionë, i cili dëshiron të marrë mallra nën regjimin e pezullimit tatimor, duhet të njoftojë me shkrim degën e tatimeve të zonës në të cilën operon dhe të marrë një leje me shkrim nga dega e tatimeve për furnizimin e anijes ose avionit. Subjekti duhet të paraqesë në degën e tatimeve një listë të nënshkruesve të autorizuar për porositjen dhe marrjen e mallrave të akcizës.

Në rrethanat kur një tatimpagues i autorizuar akcize merr një porosi për një ngarkesë të pezulluar nga akciza, nga magazina e tij tatimore e miratuar për të furnizuar një anije ose aeroplan dhe kjo ngarkesë është për t'u shitur në një udhëtim që ka një destinacion të menjëhershëm jashtë Republikës së Shqipërisë, përpara dërgimit, përveç kërkesave për lëvizje të përcaktuara në pikën 13 më lart, ai duhet të zbatojë procedurat e mëposhtme:

a) të paktën dy ditë përpara se të bëhet lëvizja e mallit, duhet të njoftojë degën e tatimeve për

porosinë, sasinë, adresën e firmës së transportit ose linjës ajrore që ka bërë porosinë, sasinë dhe përshkrimin e mallrave të akcizës në porosi; të dhënat do të paraqiten sipas formularit në shtojcën 5 dhe duhet të përfshijnë të dhënat e anijes ose aeroplanit ku do të dërgohet malli, si dhe të shoqërohet nga një kopje e porosisë së mallrave;

b) dega e tatimeve do të verifikojë nëse operatori i anijes ose avionit që ka bërë porosinë i plotëson kushtet për marrjen e mallrave të përjashtuara;

c) tatimpaguesi i autorizuar i akcizës mund të mos i dërgojë mallrat e akcizës përpara se dega e tatimeve:

i) të ketë konfirmuar me shkrim që porosia është bërë nga operatori i një anijeje ose avioni që i plotëson kushtet;

ii) të ketë vizituar magazinën tatimore të dërgimit për të verifikuar të dhënat e ngarkesës ose lejen e dhënë me shkrim për lëvizjen e mallit.

ç) një kopje e dokumentit të transportit (shoqërimit) duhet të kthehet në degën e tatimeve që mbulon magazinën tatimore të dërgimit, e firmosur nga operatori i anijes ose avionit që merr në dorëzim mallin, duke deklaruar emrin e anijes ose numrat e fluturimit të avionit në të cilin transportohen mallrat e akcizës.

Marrja në dorëzim e dërgesës sipas paragrafit 56.3 (ç) më lart mund të jetë një deklaratë doganore që tregon se mallrat janë vënë nën kontroll doganor.

Çdo furnizim i kryer sipas këtij udhëzimi do të konsiderohet si një eksport, dhe kontrolli vijues i mallrave të akcizës do të bëhet sipas procedurave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Në përfundim të dërgimit dhe pasi të jetë marrë deklarata doganore, tatimpaguesi i autorizuar i akcizës duhet të mbajë një kopje të dokumenteve në dosjet e tij dhe të deklarojë furnizimin pa pagesën e akcizës duke përdorur formularin përkatës mujor të deklarimit.

57. Rimbursimi i akcizës për eksportet me akcizë

Eksportuesit e mallrave të akcizës për të cilat është paguar akciza dhe që duan t'u rimbursohet akciza e paguar mbi mallrat e eksportuara të akcizës, mund kërkojnë një rimbursim të akcizës në përputhje me dispozitat e këtij udhëzimi.

Në rrethanat kur akciza paguhet mbi mallrat e akcizës, të cilat më pas eksportohen, rimbursimi i akcizës mund të bëhet duke përdorur formularin e kërkesës në shtojcën 22, në dy kopje, sipas kushteve të mëposhtme:

a) të jetë paguar akciza mbi ato mallra;

b) ngarkesa çohet drejtpërdrejt në vendin e eksportit së bashku me formularin e kërkesës dhe paraqitet në doganë;

c) dogana në portin e eksportit ekzaminon ngarkesën dhe lëshon një deklaratë doganore që mallrat e eksportuara korrespondojnë me mallrat e deklaruar në formularin e kërkesës;

d) lëshohet një kopje e vërtetuar e dokumentit doganor të importit që tregon se mallrat kanë mbërritur në vendin e importit dhe janë zhdoganuar në doganë, se akciza është paguar ose është siguruar në vendin e destinacionit, ose adresa e destinacionit në atë vend është një magazinë tatimore e miratuar;

e) eksportuesi është i regjistruar në organin tatimor dhe duhet të referojë NIPT-in në formularin e rimbursimit.

Pas përfundimit të eksportit dhe kur të jetë siguruar konfirmimi i eksportit, tatimpaguesi i autorizuar i akcizës duhet t'i dorëzojë dokumentet në degën e tatimeve së bashku me një kërkesë për rimbursim duke përdorur formularin e shtojcës 22.

Kur punonjësi i degës së tatimeve bindet se kërkesa për rimbursim i plotëson të gjitha kushtet e përcaktuara në paragrafin 57.2 më lart, ai mund ta pranojë kërkesën, të konfirmojë dhe të kthejë kopjen e parë të formularit të kërkesës dhe dokumentet mbështetëse dhe të mbajë kopjen e dytë në dosjen e tatimpaguesit.

Pas marrjes së një formulari kërkesë të konfirmuar dhe dokumenteve mbështetëse, tatimpaguesi i autorizuar i akcizës mund të zbresë akcizën e paguar mbi ngarkesën nga pagesa e akcizës për muajin vijues, duke deklaruar dhe duke ia bashkëngjitur kërkesën e rimbursimit deklaratës së akcizës, ose kur nuk ka akcizë për t'u paguar në gjashtë muajt pasardhës, ai mund të paraqesë një kërkesë për rimbursim në degën e tatimeve, pasi të kenë kaluar gjashtë muajt plotë kalendarikë nga data e paraqitjes së kërkesës.

Organi tatimor rimbursos tatimpaguesin e autorizuar të akcizës mbi mallrat e eksportuara të akcizës dhe ripagesa nga tatimpaguesi i autorizuar për klientët e tij e çdo shume të barabartë ose të ndryshme me akcizën që i është rimbursuar tatimpaguesit të autorizuar të akcizës sipas këtyre dispozitave është një çështje tregtare kontraktuale ndërmjet tatimpaguesit të autorizuar të akcizës dhe klientit të tij dhe nuk rregullohet nga ky udhëzim.

PJESA XV – VERIFIKIMI I VËLLIMIT DHE PESHËS

58. Verifikimi i vëllimit

58.1 Në rastin kur tatimi i akcizës mbi mallrat e akcizës llogaritet duke iu referuar vëllimit, të gjithë konteinerët e prodhimit dhe magazinimit që janë njoftuar dhe miratuar nga administrata tatimore duhet të maten dhe kalibrohen nga inspektoriati i autorizuar sipas kërkesave të administratës tatimore.

58.2 Vëllimi i mallrave të akcizës në çdo konteiner që do të merret për bazë për llogaritjen e akcizës do të jetë më i madhi nga:

a) shuma e verifikuar duke iu referuar informacionit në etiketën e konteinerit të mallrave të akcizës;

b) shuma e verifikuar duke iu referuar informacionit në faturë, dokumente transporti ose dokumente të ngjashme të lëshuara në lidhje me mallin e akcizës;

c) rezultati i ndonjë matjeje të bërë në konteinerë nga organi tatimor;

d) rezultati i ndonjë metode tjetër të përcaktuar nga organi tatimor si kusht për miratimin e magazinës tatimore.

58.3 Të gjitha instrumentet dhe pajisjet e matjes duhet të specifikohen në miratimin e magazinës tatimore dhe mund të vulosen ose të shënohen dhe identifikohen sipas konteinerit me të cilin ka lidhje instrumenti ose pajisja e matjes.

58.4 Kapaciteti i një konteineri të miratuar, të matur dhe kalibruar duhet të shënohet në njërën anë të tij dhe sasia e mallrave të akcizës ose lëngu tjetër brenda konteinerit duhet të matet duke përdorur një pajisje matëse.

58.5 Për qëllimet e këtij udhëzimi një “pajisje matëse” nënkupton:

a) një shufër druri ose metali, ose material tjetër i përshtatshëm për matje, që ka të shënuara qartë njësitë matëse me hapësira prej 1mm, përdorimi i të cilave do të sigurojë një matje të saktë të sasisë së lëngut të ngarkuar në konteiner, kur ajo të zhytet në lëngun e ngarkuar në konteiner;

b) një aparat matës vëllimi, që mund të ofrojë një matje të saktë të sasisë së mallrave të akcizës apo ndonjë lëngu tjetër të ngarkuar në konteiner;

c) një instrument matës mbi depozitën e kalibruar; ose

d) një matës automatik për nivelin e depozitës.

58.6 Çdo tatimpagues akcize i autorizuar, që është përgjegjës për matjen e mallrave të akcizës duhet të marrë masa që:

a) pajisja matëse e përdorur të ofrojë një matje të saktë;

b) pajisja matëse të jetë e sigurt dhe të mos manipulohet dhe të falsifikohet.

Për qëllimet e përdorimit të ndonjë pajisje matëse, konteineri duhet të vendoset në një pozicion vertikal dhe tatimpaguesi i autorizuar i akcizës duhet të vendosë dhe të fiksojë në një vend të përshtatshëm për kontroll çdo konteiner në të cilin prodhohen dhe magazinohen mallra akcize, si dhe të ketë marrë masa që hyrja për tek konteinerët të jetë e sigurt, në mënyrë që të mundësojë verifikimin e saktë të ngarkesës. Tatimpaguesi i autorizuar i akcizës nuk duhet të ndryshojë formën e konteinerit ose kapacitetin, derisa për këtë të autorizohet me shkrim nga organi tatimor.

Personi i miratuar është përgjegjës për matjen e saktë dhe regjistrimin në regjistrat e duhur të sasisë së lëngjeve pjesërisht ose tërësisht të prodhuara në të gjitha fazat e procesit të prodhimit dhe sasisë së mallrave të marra të akcizës ose të nxjerra nga magazina tatimore, duke përdorur pajisjet matëse.

Personi përgjegjës për matjen e vëllimit duhet të jetë në gjendje të tregojë se gjatë matjes së vëllimit është bërë ç’është e mundur për të matur vëllimin e treguar në shishe apo konteinerë të tjerë. Gjatë operacioneve për arritjen e nivelit të kërkuar duhet të bëhen saktësimet përkatëse.

58.10 Zakonisht, organi tatimor do të pranojë vëllimin e shënuar në etiketë si bazë për llogaritjen e tatimit. Megjithatë, kur organi tatimor zbulon se vëllimi i mallit të ambalazhuar është më i madh, sesa ai i treguar në etiketë, mund të bëjë një vlerësim për pagesë shtesë të akcizës.

58.11 Vëllimi i karburantit që nuk është në temperaturën 15 gradë celsius duhet të përcaktohet duke iu referuar tabelave të konvertimit që duhet të mbahen në magazinën tatimore ku është magazinuar karburanti, sipas pikës 60 më poshtë.

59. Verifikimi i temperaturës për qëllime të tatimit të karburantit

59.1 Neni 37(1) i ligjit kërkon që akciza mbi karburantin të llogaritet në një temperaturë 15 gradë celsius.

59.2 Tatimpaguesit e autorizuar të akcizës që janë përgjegjës për llogaritjen e akcizës mbi karburantin, duhet të konvertojnë matjet e ngarkesave tregtare të paambalazuara në litra standarde në një temperaturë 15 gradë celsius.

59.3 Rregullimet për temperaturën standarde duhet të llogariten në bazë të tabelave të botuara nga Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit (ISO) sipas referencës ISO 91-1 (Tabelat e matjes për naftën – Pjesa 1: Tabelat e bazuara në temperaturat e referencës prej 15 gradë celsius dhe 60 gradë Fahrenheit).

59.4 Metodatat e rregullimit për produkte të ndryshme nga ato që mbulohen nga ISO 91-1 do t'i dorëzohen për miratim organit tatimor dhe do të llogariten në bazë të tabelave ndërkombëtare si ASTM D1555: Metoda standarde për llogaritjen e vëllimit dhe peshës së hidrokarbureve aromatike industriale.

59.5 Në rrethanat kur karburanti duhet të transportohet nga një depo karburanti ose rafineri, temperatura duhet të matet me anë të njerës prej metodave të mëposhtme:

a) duke matur temperaturën e karburantit në tubacionin e shpërndarjes sa më pranë aparatit matës;

b) duke matur temperaturën në depozitën e shpërndarjes.

59.6 Çdo termometër i përdorur duhet të jetë i tillë që të masë temperaturën me saktësinë e kërkuar nga tabelat e konvertimit të përmendura në paragrafët 60.3 dhe 60.4 më lart dhe do të identifikohet nga një shenjë unike dhe që nuk fshihet, dhe do të miratohet nga dega tatimore përpara së të vihet në përdorim.

60. Verifikimi i peshës

60.1 Në rastin e mallrave mbi të cilat akciza llogaritet duke iu referuar peshës, pesha për qëllimet e llogaritjes së akcizës do të jetë më e madhja:

a) e informacionit në etiketën e konteinerit;

b) e informacionit në çfarëdo faturë, dëftesë livrimi ose dokument të ngjashëm të lëshuar në lidhje me mallrat përkatëse të akcizës;

c) e informacionit në dokumentin e importit që i nënshtrohet testimeve që doganieri i konsideron si të domosdoshme për t'u kryer;

d) duke iu referuar platformës së peshimit ose pajisjeve të tjera të peshimit që janë miratuar si pjesë e autorizimit të akcizës.

60.2 Zakonisht, organi tatimor do të pranojë peshën e etiketuar si bazë për llogaritjen e akcizës. Megjithatë, kur zbulohet se ngarkesa e mallrave të ambalazuara e tejkalon atë të paraqitur në etiketë ose në dokumente të tjera, organi tatimor mund të lëshojë një vlerësim për akcizën e papaguar.

XVI – NIVELI I REDUKTUAR MBI RAKINË

61. Përkufizimi i rakisë

61.1 Për qëllim të tabelës 1 të ligjit, “Rakia” nënkupton një pije alkoolike të prodhuar nga bërësia e rushit e fermentuar dhe e distiluar qoftë drejtpërdrejt nga avulli i ujit ose pasi të jetë shtuar uji; distilimi kryhet duke pasur bërësi në 86 për qind të vëllimit, dhe me përmbajtjen e substancave të avullueshme që janë të barabarta me ose mbi 140g për hektolitër në 100 për qind të vëllimit të alkoolit dhe kanë një përmbajtje maksimale alkooli metilik prej 1000g për hektolitër në 100 për qind vëllim alkooli.

61.2 Emërtimi ‘Raki’ përdoret vetëm për pijen alkoolike të prodhuar në mënyrën e përshkruar më lart në pikën 61.1 dhe që prodhohet në Shqipëri.

PJESA XVII – DISPOZITA TË FUNDIT

62. Përshkrimi i gabuar i mallrave të akcizës

62.1 Në bazë të nenit 44 të ligjit, përshkrimi i gabuar i produkteve të mëposhtme përbën shkelje:

- a) pije alkoolike e përshkruar si raki, por që nuk është raki;
- b) kur pija alkoolike përshkruhet si një tjetër pije alkoolike që tatohet me akcizë më të ulët sesa ajo që duhet paguar;
- c) kategoria e karburantit të përshkruar si karburant që tatohet me akcizë më të ulët sesa ajo që duhet paguar.

63. Kompetencat e organeve tatimore

Kuptimi i termit “Inspektor i autorizuar” sipas nenit 2 të ligjit përfshin inspektorët e organit tatimor.

64. Hyrja në fuqi

a) Ky udhëzim hyn në fuqi më 1 korrik 2003, me kushtet e përcaktuara në pikën (b) dhe (c) më poshtë.

b) Çdo referim i garancisë në këtë udhëzim do të hyjë në fuqi kur Ministri të nxjerrë një udhëzim tjetër në lidhje me të.

c) Çdo referim lidhur me numrat serialë në këtë udhëzim do të hyjë në fuqi kur Ministri të nxjerrë një udhëzim tjetër në lidhje me të.

MINISTRI
Kastriot Islami

LISTA E SHTOJCAVE DHE KODET PERKATESE

SHTOJCA 1	Kerkese per marrjen e autorizimit si tatimpagues i akcizes
	E-AKC003/a
SHTOJCA 2	Kerkese per miratimin e magazines tatimore
	E-AKC038/a
SHTOJCA 3	Kerkese per miratim e nje institucioni financiar si garantues i miratuar
	E-AKC039/a
SHTOJCA 4	Kerkesa per marrjen e garancise se miratuar per akcizen
	E-AKC085/a
SHTOJCA 5	Njoftim i qellimit per levizjen dhe magazinimin e mallrave nen regjimin e pezullimit tatimor
	E-AKC032/a
SHTOJCA 6	Dokumenti qe shoqeron levizjen e brendshme
	E-AKC057/a
SHTOJCA 7	Regjistri i lendeve te para (model)
	E-AKC091/a
SHTOJCA 8	Regjistri i prodhimit
	E-AKC092/a
SHTOJCA 9	Regjistri i ambalazhimit, magazinimit dhe shperndarjes
	E-AKC093/a
SHTOJCA 10	Tabela e levizjeve te tatueshme
	E-AKC098/a
SHTOJCA 11	Tabela e levizjeve nen regjim pezullimi tatimor
	E-AKC099/a
SHTOJCA 12	Regjistri i mbetjeve

	E-AKC096/a
SHTOJCA 13	Raporti i humbjeve te pazakonta
	E-AKC033/a
SHTOJCA 14	Regjistri i permbledhjes se mostrave
	E-AKC095/a
SHTOJCA 15	Regjistri i mostrave
	E-AKC097/a
SHTOJCA 16	Njoftimi i shkaterrimit
	E-AKC031/a
SHTOJCA 17	Formulari i deklarimit dhe i pageses se akcizes
	E-AKC010/a
SHTOJCA 18	Formulari i porosise se pullave te akcizes
	E-AKC075/a
SHTOJCA 19	Regjistri i kontrollit te pullave te akcizes
	E-AKC094/a
SHTOJCA 20	Raporti i perdorimit te pullave te akcizes
	E-AKC034/a
SHTOJCA 21	Kerkesa per rimbursimin e pullave te akcizes
	E-AKC081/a
SHTOJCA 22	Kerkesa per rimbursimin e akcizes
	(22a) E-AKC082/a (22b)E-AKC083/a (22c) E-AKC0xx/a (22d) E-AKC084/a

SHTOJCA 1 – KERKESE PER MARRJEN E AUTORIZIMIT SI TATIMPAGUES I AKCIZES

Kerkesa per Regjistrim si Tatimpagues Akcize i Autorizuar

Ju lutemi te lexoni shenimet e bashkengjitura perpara se te plotesoni formularin

NIPT: Shih shenimin 1	1.
Emri i subjektit: Shih shenimin 2	2.
Emri i aplikantit: Shih shenimin 3	3.
Adresa e aplikantit: Shih shenimin 4	Rruga Qyteti Rrethi 4.
Statusi i subjektit: Fshijeni sipas rastit	5. Shoqeri tregtare shqiptare/ shoqeri tregtare e huaj/ shoqerie e perbashket
Lloji i sipermarrjes: Fshijeni sipas rastit	6. Firme me pergjegjesi te kufizuar/ Person fizik/ Kolektiv/ Anonim/ Komandite/ Trup diplomatik/ Ent publik/ Te tjere.....
Vendi kryesor i biznesit: Shih shenimin 5	Rruga Qyteti Rrethi 7.
Numri i telefonit te subjektit:	8.
Email:	9.

Te dhena mbi subjektin e akcizes qe do te autorizohet:
Shih shenimin 6
Per perfaqesuesin tatimorl shih shenimin 13

10.
Prodhues i mallrave te akcizes
Eksportues i mallrave te akcizes nen pezullim tatimor
Importues i ngarkesave tregtare te mallrave te akcizes per perpunim
Prodhues i produkteve mjekesore
Prodhues i alkoolit te denatyrUAR
Prodhues i uthulles
Perfaqesues fiskal

Data e fillimi te biznesit te akcizes:
Shih shenimin 7

11.

Te dhena per autorizimin e meparshem te akcizes:
Shih shenimin 8

Numri:
Lloj:
Data nga/deri:
Dega tatimore:
Arsyeja e perfundimit:

12.

A do te beni gjithashtu kerkese edhe per miratimin e magazines tatimore?
Shih shenimin 9

Po:

13.

Jo: Kerkesa e perkohshme e bashkengjitur

14.

Ju lutemi kthejeni fleten dhe plotesoni faqen dy 15.

Adresat dhe funksionet e te gjitha magazinave tatimore qe do te operohen nese merret miratimi:

Magazina 1: Shih shenimin 10	Rruga Qyteti Rrethi Funksioni
Magazina 2: Shih shenimin 10	Rruga Qyteti Rrethi Funksioni
Magazina 3: Shih shenimin 10	Rruga Qyteti Rrethi Funksioni
Magazina 4: Shih shenimin 10	Rruga Qyteti Rrethi Funksioni

15.1

15.2

15.3

15.4

Magazina te tjera jane paraqitur me hollesi ne fleten e bashkengjitur ne vazhdim
Shih shenimin 11

16.

17. Deklarate Shih shenimin 12	Une deklaroj: Jam nje person i besueshem dhe i rregullt siç percaktohet ne Udhezimin e Akcizes Nr. [] Date[] Po bej kerkese per miratimin e magazines/ve tatimore dhe kam bashkengjitur formularin* perkates te kerkeses; ose Une nuk po bej kerkese tani per magazine tatimore por kam siguruar informacionin e kerkuar ne formularin* e bashkengjitur te kerkeses *fshijeni sipas rastit Kam paguaren tarifen e kerkuar prej 10,000 lek per shqyrtimin e kesaj kerkese dhe kam bashkengjitur konfirmimin e pageses
--------------------------------------	---

Nenshkrimi dhe data

Nenshkrimi	Data
------------	------

Emri i plote me GERMA SHTYPI,
pozicioni dhe statusi

Emri	Statusi
------	---------

Per perdorim zyrtar	Data	Nenshkrimi
Data a marrjes		
NIPT-i i verifikuar		
Verifikimi nese ka nje status te rregullt dhe te pershtatshem		
Data e dhenis se autorizimit		
Numri i autorizimit		

SHENIMET LIDHUR ME KERKESEN PER MARRJEN E AUTORIZIMIT SI TATIMPAGUES I AKCIZES

Shenim1: Per te bere kerkese per marrjen e nje autorizimi si tatimpagues akcize duhet te jeni te regjistruar tashme ne organin tatimor dhe te jeni paisur me nje NIPT. Nese keni nje NIPT ju lutemi te beni kerkese per nje numer ne degen tuaj tatimore ne rreth perpara se te vazhdoni me kete aplikim.

Shenim2: Ky eshte emri i subjektit dhe duhet shenuar ateher kur ekziston nje i tille. Nese kjo kerkese behet ne emer te pronarit ateher shenoni emrin e tij ketu.

Shenim3: Shenoheni emrin e plote te pronarit te subjektit, administratorit nese eshte firme me pergjegjesi te kufizuar ose pergjegjesit ekzekutiv nese eshte forme tjeter biznesi.

Shenim4: Shenoheni adresen private te pronarit te biznesit, administratorit ose pergjegjes ekzekutiv sipas rastit.

Shenim5: Kjo eshte adresa nga ku drejtohet veprimtaria ekonomike e subjektit. Mund te jete nje nga magazinat, ose zyra qendrore e shoqerise. Ne pergjithesi te dhenat per subjektin (me perjashtim te atyre qe duhet te mbahen ne magazine) do te mbahen ne vendin kryesor te biznesit. Ai eshte gjithashtu vendi ku do te bejme vizitat per intervistimin e drejtuesit e sipermarrjes dhe vendi ku do te dergojme korrespondencen, pervec correspondences se vecante te magazines.

Lini numrin tuaj te telefonit ku mund t'ju kontaktojme. Nuk keni nevojte te lini nje adrese e-maili por do te na ndihmonte t'ju kontaktonim nese nevojitet.

- Shenim6: Deklaroni veprimtarite e subjektit, duke perzgjedhur nga lista e dhene. Duhet te fshini te gjitha veprimtarise qe nuk i kryeni.
- Shenim7: Shenoheni daten kur keni filluar biznesin e prodhimit apo tregtise se mallrave te akcizes, ose nese kjo eshte nje kerkese e re, daten kur synoni te filloni.
- Shenim8: Shenoni ndonje autorizim qe keni patur me pare per biznes akcize, duke dhene numrin e autorizimit, per cfare ishte autorizimi, periudhen e vlefshmerise se autorizimit, dhe arsyen e perfundimit apo revokimit.
- Shenim 9: Nese po beni kerkese vetem per te marre autorizim si tatimpagues akcize, spontoni kutine perkatese. Megjithate, nese keni ndermend te ndermerrni ndonje veprimtari qe kerkon nje miratim per magazine tatimore, ju duhet te bashkengjisni nje formular te perkohshem “Kerkese per miratim magazine tatimore” duke paraqitur te dhenat qe kerkohen ne ate formular. Te dhena te tjera mund te gjenden ne formularin per miratimin e magazines.
- Shenim10: Shenoni te dhenat e te gjitha magazinave. Funksioni duhet te perzgjidhet nga lista e meposhtme. Kur keni planifikuar me shume se nje funksion shenoni te gjitha funksionet:
 Perpunim dhe magazinim kafeje
 Perpunim dhe magazinim pijesh jo-alkoolike
 Prodhim birre
 Prodhim vere, vere molle etj
 Ambalazhim ne shishe e veres se molles
 Magazinim i veres se molles
 Prodhim i alkoolit dhe pijeve alkoolike
 Ambalazhim ne shishe i alkoolit dhe pijeve alkoolike
 Magazinim i alkoolit dhe pijeve alkoolike
 Prodhim i rakise
 Ambalazhim i rakise
 Magazinim i rakise
 Prodhim duhani
 Magazinim duhani
 Perpunim i vajit te hidrokarbureve
 Magazinim i vajit te hidrokarbureve
 Prodhim dhe magazinim i parfumeve, kolonjave dhe deodoranteve.
- Shenim11: Nese keni aplikuar apo deshironi te aplikoni per me shume se tre miratime magazinash tatimore, shenoni PO ne kuti dhe paraqisni te dhenat te tjera ne nje flete tjeter te bardhe dhe bashkengjiteni ate ne formularin e kerkeses.
- Shenim12: Nese firmosni formularin duhet te jeni te autorizuar per te vepruar ne emer te subjektit. Kjo nenkupton qe per nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, ju duhet te jeni drejtori apo sekretari i asaj shoqerie, nese shoqeria eshte e pakufizuar, ju duhet te jeni pronari i vetem, ose administratori i entitetit te biznesit.
- Per te bere kerkese ju duhet te jeni nje “person i besueshem dhe i rregullt”. Kjo nenkupton qe ju (dhe shoqeria) duhet:
 Te mos keni detyrime te pashlyera ne lidhje me tatime te papaguara ndaj Administrates tatimore;
 Te mos u detyroheni shuma ndonje departamenti tjeter shteteror;
 Te mos keni kontribute sigurimesh shoqerore apo taksa dhe tatime lokale te papaguara;
 Te mos keni vuajtur ndonje lloj denimi pese vitet e fundit
 Te keni nje adrese tregtare ne Republiken e Shqiperise;

Te keni aftesi te siguron garancite e kerkuara sipas Pjeses III te Udhhezimeve te akcizes;
Te jeni i afte te zbatoni kerkese te ligjit ne lidhje me tatimin e akcizes.

Berja e nje deklarate te rreme me qellim marrjen e autorizimit si tatimpagues akcize
rezulton ne venien e gjobave dhe revokimin e autorizimit te dhene, se bashku me
revokimin e çdo miratimi te dhene per magazine tatimore ne lidhje me kete autorizim.

Ju duhet t'ia bashkengjisni kesaj kerkese formularin e zakonshem te pageses te vulosur
nga banka per te konfirmuar pagesen e tarifes administrative prej 10,000 Lek

Shenim13: Nje perfaqesues tatimor duhet te plotesoje vetem kutite 1 deri 10 dhe deklaraten ne
kutine 17.

Shenim14: Ky formular duhet te dorezohet ne:
Degen tatimore qe mbulon vendin kryesor te biznesit nese ju operoni nga magazina qe
ndodhen ne vendndodhje te ndryshme; ose
Degen tatimore qe mbulon magazinën nese ju operoni vetem nje magazine.

Shenim15: Ju lutemi te keni parasysh qe shenimet ne kete fomular kane fuqi ligjore.

SHTOJCA 2 – KERKESE PER MIRATIMIN E MAGAZINES TATIMORE

Kerkese per Miratimin e Magazines Tatimore

Ju lutemi te lexoni shenimet e baskengjitura perpara se te plotesoni kete formular

Emri dhe NIPT-i i aplikantit: Shih
shenimin 1

1. Emri

2. NIPT

Autorizimi i akcizes per aplikantin.
Shih shenimin 2

Numer:
Data e leshimit:
Zyra e leshimit:

3.

Adresa e magazines:
Shih shenimin 3

Rruga

Qyteti

Rrethi

4.

Magazina/kontakt tel:
Shih shenimin 4

5.

Email:

6.

Te dhena te biznesit te akcizes qe do te
kryhet ne magazine:
Shih shenimin 5

7.1

7.2

7.3

7.4

7.5

Sasia e parashikuar vjetore dhe

Sasia vjetore

Detyrimi vjetor i akcizes

8.1	
8.2	
8.3	
8.4	
8.5	

9.

10.
11.
12.

14.

15.

16.....

1845

Cila eshte perqindja normale e humbjes ne çdo faze te procesit te prodhimit? Shih shenimin 13.	Stadi i procesit	Humbja normale %
	18.1	
	18.2	
	18.3	
	18.4	
	18.5	

Pershkrimi i produktit 2:	Kodi NK	Pershkrimi	Sasia dhe njesia
Jepni kodin NK, pershkimin dhe sasine e lendes se pare te perdorur per prodhimin e nje njesie malli akcize Shih shenimin 12	19.1		
	19.2		
	19.3		
	19.4		
	19.5		
	19.6		

Cila eshte perqindja normale e humbjes ne çdo faze te procesit te prodhimit? Shih shenimin 13.	Faza e procesit	Humbja normale %
	20.1	
	20.2	
	20.3	
	20.4	
	20.5	

Ju lutemi kthejeni fleten dhe plotesoni fagen 3

Pershkrimi i produktit 3:	Kodi NK	Pershkrimi	Sasia dhe njesia
Jepni kodin NK, pershkimin dhe sasine e lendes se pare te perdorur per prodhimin e nje njesie mallrash akcize Shih shenimin 12	21.1		
	21.2		
	21.3		
	21.4		
	21.5		
	21.6		

Cila eshte perqindja normale e humbjes ne çdo faze te procesit te prodhimit? Shih shenimin 13.	Faza e procesit	Humbja normale %
	22.1	
	22.2	
	22.3	
	22.4	
	22.5	

Produktet e metejshme [] jane renditur ne fleten vijuese te bashkengjitur.
Shih shenimin 12

Nese do te ngjisni pulla akcize paraqisni informacionin e meposhtem:

Permasat e njesive te ambalazhuara per te cilat do te nevojiten pullat e akcizes

Si do te ngjiten pullat e akcizes

Lloji i paisjes se perdorur:

23.	
24. Me dore/makineri	* fshijeni sipas rastit
25.	

A do te perdoret magazina per magazinim dhe shperndarje? Shih shenimin 14

26.

Nese magazina do te perdoret per magazinim dhe shperndarje ju lutem paraqisni te dhenat e meposhtme per çdo lloj malli te akcizes: Shih shenimin 15			
Produkt	27.1	Produkt	28.1
Magazinimi mujor maksimal – sasia	27.2	Magazinimi mujor maksimal – sasia	28.2
Detyrimi tatimor i magazinimit mujor maksimal	27.3	Detyrimi tatimor i magazinimit mujor maksimal	28.3
Prodhimi vjetor	27.4	Prodhimi vjetor	28.4
Produkt	29.1	Produkt	30.1
Magazinimi mujor maksimal – sasia	29.2	Magazinimi mujor maksimal – sasia	30.2
Detyrimi tatimor i magazinimit mujor maksimal	29.3	Detyrimi tatimor i magazinimit mujor maksimal	30.3
Prodhimi vjetor	29.4	Prodhimi vjetor	30.4

Ju lutem kthejeni fleten dhe plotesoni faqen 4

Nenshkruesit e Autorizuar:
Shih shenimin 16

Emri dhe Funksionii	31.1	Nenshkrimi	31.2
Emri dhe Funksioni	31.3	Nenshkrimi	31.4
Emri dhe Funksioni	31.5	Nenshkrimi	31.6
Emri dhe Funksioni	31.7	Nenshkrimi	31.8

32. Deklarate Shih shenimin 17	Une deklaroj: Informacioni i dhene ne kete formular kerkese eshte i vertete dhe i plote; Une kam nje autorizim per tatimpagues akcize siç eshte shenuar ne kutine 3 me lart, dhe kam bashkengjitur nje kopje te autorizimit; Une po bej kerkese per miratimin e ambjenteve ne adresen e shenuar ne kutine 4 me lart si magazine tatimore; Une kam deklaruar ne kerkesen per nje autorizim si tatimpagues akcize, te gjitha magazinat tatimore qe jane prone e imja dhe operohen nga une; Une kam nje garanci*/ kam nje garanci te perkohshme te miratuar ne varesi te suksesit te kesaj kerkese* qe perben nje shume te mjaftueshme per akcizen e pezulluar, *Fshijeni sipas rastit Plani i magazines tatimore i bashkengjitur kesaj kerkese tregon sakte ndertimin dhe skicen e magazines tatimore te propozuar; Une e kuptoj dhe mund te zbatoj kerkesat per mbajtjen e te dhenave; Une kam paguar tarifen e kerkuar prej 10,000 lek per perpunimin e kesaj kerkese dhe kam bashkengjitur nje vertetim te kesaj pagese.
Shih shenimi 18	

Nenshkrimi dhe data

Nenshkrimi	Data
------------	------

Emri i plote me
GERMA TE MEDHA
pozicioni ose statusi

Emri	Status
------	--------

Per perdorim zyrtar	Data	Nenshkrimi
Data e marrjes		
NIPT-i i verifikuar		
Autorizimi i akcizes i verifikuar		
Sondazhi i kryer	Jo i kenaqshem* I kenaqshem* (fshijeni)	
Miratimi i dhene		
Numri i miratimit		

SHENIMET E KERKESES PER MIRATIMIN E MAGAZINES

Shenim1: Per te bere kerkese per miratimin e magazines ju duhet te jeni tashme te regjistruar ne organin tatimore dhe te keni nje NIPT. Nese nuk keni nje NIPT ju lutemi te beni kerkese per nje numer ne degen e tatimeve ne rreth perpara se te vazhdoni me kete kerkese.

Shenim2: Per te bere kerkese per marrjen e nje miratimi per magazine tatimore ju duhet te keni marre tashme nje autorizim per tatimpagues akcize nga organi tatimor dhe te keni numrin e autorizimit te akcizes. Nese nuk e keni nje numer, ju lutemi te beni kerkese per nje numer ne degen tatimore perkatese (shikoni per detaje formularin e “Kerkeses per marrjen e autorizimit si tatimpagues akcize”) perpara se te vazhdoni me kete kerkese.

Ju duhet t’i bashkengjisni kesaj kerkese nje kopje te autorizimit tuaj si tatimpagues akcize.

Shenim3: Kjo eshte adresa e magazines. Nese magazina nuk eshte ndertuar akoma, ju lutemi te paraqisni te dhena te mjaftueshme te vendndodhjes se propozuar.

Per çdo magazine tatimore duhet te beni nje kerkese te veçante.

- Shenim4: Lini numrin e telefonit te magazines. Nese magazina nuk ka lidhje telefonike atehere lini nje numer telefoni te personit te ngarkuar me operacionet ne magazine – p.sh., nje numer celulari ose numrin e tel. te zyrave qendrore te shoqerise.
- Ju nuk keni nevojte te lini nje Email por nese do ta lini do te na ndihmoje te komunikojme me ju.
- Shenim5: Funksioni duhet te perzgjidhet nga lista e meposhtme. Nese eshte planifikuar me shume se nje funksion shenoni te gjitha funksionet duke filluar me ate kryesorin:
 Perpunim dhe magazinim kafeje
 Perpunim dhe magazinim pijesh jo-alkoolike
 Prodhim birre
 Ambalazhi/hedhja ne fuçi e birres
 Magazinimi i birres
 Prodhimi i veres, veres se molles etj
 Taposja e veres se molles etj
 Magazinimi i veres se molles etj
 Prodhim i alkoolit dhe pijeve alkoolike
 Balazhimi i alkoolit dhe pijeve alkoolike
 Magazinim i alkoolit dhe pijeve alkoolike
 Prodhim i rakise
 Ambalazhimi i rakise
 Magazinim i rakise
 Perpunim duhani
 Magazinim i produkteve te duhanit
 Perpunim i vajit te hidrokarbureve
 Magazinim i vajit te hidrokarbureve
 Prodhimi i parfumeve, kolonjave dhe deodoranteve
 Prodhues i produkteve te njohura mjekesore
 Prodhues i alkoolit te denatruar
 Prodhues i uthulles
- Shenim6: Jepni sasine e parashikuar te mallrave te akcizes per çdo funksion te dhene ne kutine 7. Njesia e perdorur duhet te jete njesia e peshes, vellimit etj e perdoret per te llogaritur akcizen.
- Shenim7: Jepni daten ne te cilen mendoni te filloni biznesin e akcizes ne magazine, ne lidhje me miratimin e dhene. Kjo date nuk mund te jete me pak se 30 dite nga data e kesaj kerkese, perveçse ne rastet kur ju jeni tashme nje tatimpagues akcize, ne kete rast shenoni daten ne te cilen keni filluar biznesin e akcizes ne magazinën e autorizuar.
- Shenim8: Per te marre miratimin duhet te keni nje garanci. Nese nuk deshironi te mbani nje garanci deri ne miratimin e kerkeses, ju mund te beni kerkese per nje garanci te perkohshme. Kesaj kerkese duhet t'i bashkengjisni (me kapese) ose kopjen e nje garancie ose nje leter nga nje garantues i miratuar qe konfirmon se garancia do te jepet kur te kerkohet.
- Ju lutemi te paraqisni emrin e garantuesit, shumen e detyrimit tatimor te garantuar (nese garancia eshte e perkohshme, thoni shumen qe do te garantohet nese miratohet kerkesa), dhe numrin e garancise te leshuar nga organi tatimor (shenoni “i perkohshem” sipas rastit ne kutine 12).
- Shenim9: Nese keni qellim te mbani te dhenat ne nje sistem te informatizuar, ky i fundit duhet te miratohet nga organi tatimor – spontoni kutine 13. Nese programi juaj kompjuterik eshte nje program qe blihet i gatshem ne treg, shenoni emrin e produktit ne kutine 14. Nese

është një sistem që e keni ndertuar vetë, shenoni 'i bërë me porosi' në kutinë 14. Përpara blerjes apo ndertimit të ndonjë sistemi duhet të keshilloheni me organin tatimor, i cili duhet të jetë në gjendje të ruajë të dhënat dhe të nxjerrë raportet e kërkuara nga Udhezimi i Akcizës.

Shenim10: Nëse dëshironi të prodhoni mallra akcize në magazine, shenoni PO në kuti dhe plotësoni kutitë 16-26 me poshtë. Nëse nuk do të prodhoni mallra në magazine atëherë vazhdoni me kutinë 26.

Shenim11: Ju lutemi të shpjegoni procesin e prodhimit që do të perdoret në magazinën tatimore të propozuar, të cilit i referohet kjo kërkesë, dhe që tregon sesi do të perdoren lëndet e para, produktet e mesme që do të prodhohen, dhe produkti përfundimtar.

Shenim12: SHIFRAT QË KERKOHEN NË KETË PJESË JANË LËNDËT E PËRA TË PERDORURA PËR TË PRODHUAR TEORIKISHT SASINË MAKSIMALE TË MALLRAVE TË PERFUNDUARA QË MUND TË PRODHOHEN, NËSE NUK KË PASUR HUMBJE NË PRODHIM APO MAGAZINIM.

Perdorni një listë të veçantë për çdo mall akcize të prodhuar. Nëse do të prodhoni më tepër se tre lloje të mallrave të akcizës, paraqisni të dhënat për mallrat shtesë në një fletë të veçantë dhe bashkangjitja këto formularit të kërkesës.

Ju lutem rendisni lëndet e para KRYESORE, peshën/velimin e perdorur për prodhimin e mallrave të akcizës – nuk keni nevojë të rendisni çdo lëndë të parë.

Kodi NK është numri brenda Nomenklaturës Doganore dhe i referohet lëndëve të para që keni ndermend të perdorni. Për shembull, nëse keni ndermend të perdorni rrush për të bërë verë, kodi NK është 08 06.

Njësia e cituar për mallrat e perfunduara duhet të jetë njësia e peshës, vellimit etj., që perdoret për llogaritjen e akcizës.

Shenim13: Ju duhet të tregoni sasinë e mallrave të gatshme ose në mes të procesit që kanë humbur gjatë perpunimit për shkak të faktoreve të pashmangshëm. Tregoni humbjet normale në çdo stad të procesit. Megjithatë, humbjet e përjashtuara nga detyrimi i akcizës nuk duhet të tejkalojnë ato që paraqiten në udhëzimet e akcizës edhe nëse gjatë procesit keni humbje më të mëdha.

Shenim14: Nëse magazina do të perdoret vetëm për magazinim dhe shpërndarje të mallrave të akcizës, nuk është e nevojshme të plotësohen kutitë 16-26 më lart.

